




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/ Ministarstvo Trgovine i Industrije/Ministry of Trade the Industry

Departamenti i Industrisë/Odeljenje Industrije/Department of Industry

Divizioni për Politika Industriale/Odsek za industrijske politike/ Division for Industrial Policy

RAPORTI



SEKTORI C

: X + - =

INDUSTRIA PËRPUNUESE

KRAHASIMI NËN SEKTORIAL

- Ndërmarrjet
- Punësimi
- Eksporti
- Importi

PËRMBAJTJA

Shkurtesat e përdorura.....	5
Lista e tabelave.....	6
Lista e figurave.....	7
Hyrje.....	9
Metodologjia.....	10

PJESA E PARË

KRAHASIMI I NËNSEKTORËVE TË SEKTORIT C.....	11
1 Ndërmarrjet sipas nën sektorëve.....	13
2 Punësimi sipas nën sektorëve.....	14
3 Eksporti sipas nën sektorëve.....	15
4 Importi sipas nën sektorëve.....	16

PJESA E DYTË

KRAHASIMI I AKTIVITETEVE TË NËNSEKTORËVE.....	17
1 Prodhimi i tekstilit.....	17
1.1 Ndërmarrjet sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit.....	18
1.2 Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit.....	19
1.3 Eksporti sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit.....	20
1.4 Importi sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit.....	21
2 Prodhimi i veshjeve.....	23
2.1 Ndërmarrjet sipas aktiviteteve të nën sektori i veshjeve.....	24
2.2 Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i veshjeve.....	25
2.3 Eksporti sipas aktiviteteve të nën sektori i veshjeve.....	26
2.4 Importi sipas aktiviteteve të nën sektori i veshjeve.....	27
3 Prodhimi i Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës.....	29
3.1 Ndërmarrjet sipas aktiviteteve të nën sektori i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës.....	30
3.2 Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës.....	31
3.3 Eksporti sipas aktiviteteve të nën sektori i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës.....	32

3.4	Importi sipas aktiviteve te nën sektori i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës.....	33
4	Prodhimi i Drurit dhe i Produkteve të Drurit dhe të Tapës, përveç Mobilieve; Prodhimi i Artikujve nga Kashta dhe Materialeve të Gërshetuara-Thurëse	34
4.1	Ndërmarrjet sipas aktiviteve te nën sektori i drurit.....	35
4.2	Punësimi sipas aktiviteve te nën sektori i drurit.....	36
4.3	Eksporti sipas aktiviteve te nën sektori i drurit.....	37
4.4	Importi sipas aktiviteve te nën sektori i drurit.....	38
5	Prodhimi i Letrës dhe Produkteve prej Letrës.....	40
5.1	Ndërmarrjet sipas aktiviteve te nën sektori i letrës dhe produkteve prej letrës.....	41
5.2	Punësimi sipas aktiviteve te nën sektori i letrës dhe produkteve prej letrës.....	42
5.3	Eksporti sipas aktiviteve te nën sektori i letrës dhe produkteve prej letrës.....	43
5.4	Importi sipas aktiviteve te nën sektori i letrës dhe produkteve prej letrës.....	44
6	Prodhimi i Produkteve Kimike.....	46
6.1	Ndërmarrjet sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve kimike.....	47
6.2	Punësimi sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve kimike.....	48
6.3	Eksporti sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve kimike.....	49
6.4	Importi sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve kimike.....	50
7	Prodhimi i Produkteve të Gomës dhe të Plastikës.....	52
7.1	Ndërmarrjet sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës.....	52
7.2	Punësimi sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës.....	53
7.3	Eksporti sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës.....	54
7.4	Importi sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës.....	56
8	Prodhimi i Metaleve.....	58
8.1	Ndërmarrjet sipas aktiviteve te nën sektori i prodhimit të metaleve.....	59
8.2	Punësimi sipas aktiviteve te nën sektori i prodhimit të metaleve.....	60
8.3	Eksporti sipas aktiviteve te nën sektori i prodhimit të metaleve.....	61
8.4	Importi sipas aktiviteve te nën sektori i prodhimit të metaleve.....	62
9	Prodhimi i Produkteve të Fabrikua Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve	64
9.1	Ndërmarrjet sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të fabrikua metalike.....	65
9.2	Punësimi sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të fabrikua metalike.....	66
9.3	Eksporti sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të fabrikua metalike.....	67

9.4	Importi sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të fabrikua metalike.....	68
10	Prodhimi i Mobileve.....	70
10.1	Ndërmarrjet sipas aktiviteve te nën sektori i mobileve.....	70
10.2	Punësimi sipas aktiviteve te nën sektori i mobileve.....	71
10.3	Eksporti sipas aktiviteve te nën sektori i mobileve.....	72
10.4	Importi sipas aktiviteve te nën sektori i mobileve.....	73
11	Përmbledhja.....	75
12	Konkludimet.....	78
13	Referencat.....	79

Lista e shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	-	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	-	Bashkimi Evropian
BKK	-	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BPV	-	Bruto Prodhimi Vendor
BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
CEFTA	-	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
DI	-	Departamenti i Industrisë
DK	-	Dogana e Kosovës
DPI	-	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Industriale
EFTA	-	Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë
IHD	-	Investimet e Huaja Direkte
IÇK	-	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IÇP	-	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
KTD	-	Korporata Tjera Depozituese
MTI	-	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MTLEQ	-	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore
NMVID	-	Norma Mesatare Vjetore e Interesit në Depozite

Lista e tabelave

Tabela 1-	Nën sektorët e industrisë përpunuese sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit.....	12
Tabela 2-	Nën sektori i prodhimit të tekstilit sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit.....	17
Tabela 3-	Nën sektori i prodhimit të veshjeve sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit.....	23
Tabela 4-	Nën sektori i prodhimit të lëkurës sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit.....	29
Tabela 5-	Nën sektori i prodhimit të drurit dhe produkteve prej drurit dhe të tapës, përveç mobileve sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit.....	34
Tabela 6-	Nën sektori i prodhimit të letrës sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit.....	40
Tabela 7-	Nën sektori i prodhimit të produkteve kimike sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit.....	46
Tabela 8-	Nën sektori i prodhimit të gomës dhe plastikës sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit.....	52
Tabela 9-	Nën sektori i metaleve sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit.....	58
Tabela 10-	Nën sektori i prodhimeve të fabrikuara metalike sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit.....	64
Tabela 11-	Nën sektori i prodhimit të mobileve sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit.....	70

Lista e figurave

Figura 1-	Radhitja e nën sektorëve të sektorit C, sipas përqindjes në numër të ndërmarrjeve.	13
Figura 2-	Punësimi sipas nën sektorëve të sektorit C.....	14
Figura 3-	Eksportet sipas nën sektorëve të sektorit C.....	15
Figura 4-	Importi sipas nën sektorëve të sektorit C.....	16
Figura 5-	Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit.....	18
Figura 6-	Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit.....	19
Figura 7-	Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit.....	20
Figura 8-	Importet sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit.....	22
Figura 9-	Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektori i veshjeve.....	24
Figura 10-	Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i veshjeve.....	25
Figura 11-	Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i veshjeve.....	26
Figura 12-	Importi sipas aktiviteteve të nën sektori i veshjeve.....	27
Figura 13-	Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të lëkurës dhe produkteve të lëkurës.....	30
Figura 14-	Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të lëkurës dhe produkteve të lëkurës.....	31
Figura 15-	Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të lëkurës dhe produkteve të lëkurës.....	32
Figura 16-	Importet sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të lëkurës dhe produkteve të lëkurës.....	33
Figura 17-	Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të drurit...	35
Figura 18-	Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të drurit.....	36
Figura 19-	Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të drurit.....	37
Figura 20-	Importet sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të drurit.....	39
Figura 21-	Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektori i letrës.....	41
Figura 22-	Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i letrës.....	42
Figura 23-	Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i letrës.....	43
Figura 24-	Importet sipas aktiviteteve të nën sektori i letrës.....	44
Figura 25-	Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve kimike..	47
Figura 26-	Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve kimike.....	48
Figura 27-	Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve kimike.....	49

Figura 28-	Importet sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve kimike.....	51
Figura 29-	Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës.....	53
Figura 30-	Punësimi sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës.....	54
Figura 31-	Eksportet sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës.....	55
Figura 32-	Importi sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës.....	56
Figura 33-	Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteve te nën sektori i metaleve.....	59
Figura 34-	Punësimi sipas aktiviteve te nën sektori i metaleve.....	60
Figura 35-	Eksportet sipas aktiviteve te nën sektori i metaleve.....	61
Figura 36-	Importet sipas aktiviteve te nën sektori i metaleve.....	62
Figura 37-	Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të fabrikua metalike.....	65
Figura 38-	Punësimi sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të fabrikua metalike.....	66
Figura 39-	Eksportet sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të fabrikua metalike.....	67
Figura 40-	Importet sipas aktiviteve te nën sektori i produkteve të fabrikua metalike.....	69
Figura 41-	Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteve te nën sektori i mobileve.....	71
Figura 42-	Punësimi sipas aktiviteve te nën sektori i mobileve.....	72
Figura 43-	Eksportet sipas aktiviteve te nën sektori i mobileve.....	73
Figura 44-	Importet sipas aktiviteve te nën sektori i mobileve.....	74

Hyrje

Politika industriale, është temë aktuale dhe zë vend të rëndësishëm në agjendat e vendeve me ekonomi të zhvilluar. Kosova, si një shtet i ri, është duke synuar që nëpërmes avancimit të politikave industriale të ndikojë në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

Kosova, edhe pse është një ndër vendet e pakta në rajon që ka përjetuar një normë solide të rritjes ekonomike, madje edhe gjatë krizës financiare botërore, ka nevojë për një ritëm shumë më të shpejtë të rritjes së punësimit, numrit të ndërmarrjeve dhe eksporteve në industri, për të përmirësuar standardin e jetesës si dhe të ekuilibrojë bilancin e saj të madh negativ tregtar.

Rritja globale e prodhimit është temë aktuale e vendeve të zhvilluara, në këtë rast Kosova duhet të orientohet më tepër në zhvillimin e sektorëve të industrisë përpunuese e cila kontribuon drejtpërsëdrejti në rritjen e vlerës së prodhimit në vend si dhe në rritjen e numrit të punësuarve me profile të ndryshme.

Hartuesit e politikave industriale në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për ta analizuar gjendjen e trendëve të zhvillimit të industrisë përpunuese (Sektori C), kanë përgatitur **Raportin krahasues me nën sektorët e sektorit C.**

Qëllimi i hartimit të Raportit krahasues të nën sektorëve të sektorit C, është paraqitja e trendëve kryesore të zhvillimit të nën sektorëve dhe aktiviteteve të ekonomisë së Kosovës.

Të dhënat e prezantuara në këtë raport, janë të dhënat për vitin 2018, të cilat mund t'iu shërbejnë politikë-bërësve në procesin e zhvillimit ekonomik në Kosovë, bizneseve operuese, (të tanishme dhe ato potenciale nga sektori privat), investitorëve, donatorëve, hulumtuesve, akademikëve, etj. Më konkretisht, përmes këtij Raporti, i cili ofron një pasqyrë më të qartë rreth nën sektorëve dhe aktiviteteve të sektorit C, me ndikim në industrinë e vendit, do t'iu lehtësohet puna të gjithë akterëve përkatës në hartimin e politikave zhvillimore më të efektshme, bazuar në indikatorë të matshëm.

Metodologjia

Të dhënat e përdorura në këtë raport, bazohet në të dhënat sasiore dhe cilësore të pranuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Këto të dhëna, janë përpunuar dhe analizuar nga stafi i MTI-së, konkretisht nga përpunuesit e statistikave dhe hartuesit e Politikave Industriale në Departamentin e Industrisë. Për të gjitha të dhënat që janë përdorur në këtë raport, janë shënuar thirrjet apo burimi i informatave.

Në pjesën e parë të këtij raporti janë prezantuar të dhënat statistikore të përgjithshme për Industrinë përpunuese të Sektorit C, ku janë analizuar dhe krahasuar të dhënat për numrin e ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit në mes nën sektorëve.

Pjesa e dytë, prezanton të dhënat në numër të ndërmarrjeve, punësim, eksport dhe import, duke krahasuar aktivitetet e nën sektorëve si: Tekstili, Veshja, Lëkura, Druri, Letra, Industria Kimike, Prodhimi i Produkteve të Fabrikuar Metalike (përveç Makinerisë dhe Pajisjeve), Plastika dhe Goma, Metalet si dhe Prodhimi i Mobileve. Përshkrimi i këtyre nën sektorëve, në këtë Raport është radhitur sipas kodeve, ashtu siç janë të radhitura në NACRev2.

Pas analizave të paraqitura lidhur me të dhënat e përgjithshme dhe trendët për industrinë, në këtë raport janë ofruar edhe konkluzionet që kanë të bëjnë me industrinë përpunuese në Kosovë.

PJESA E PARË

KRAHASIMI I NËNSEKTORËVE TË INDUSTRISË PËRPUNUESE

Industria përpunuese është ndër sektorët kyç dhe me ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Zhvillimi i sektorit të industrisë përpunuese indirekt kontribuon në sektorët e tjerë ekonomikë. Kosova vazhdon të ketë zhvillim të ultë të sektorit C, me gjithat disa nga nën sektorët kanë treguar se kanë potencial të zhvillimit dhe depërtimit në tregjet ndërkombëtare.

Roli i nën sektorëve përpunues të prezantuar në tabelën 1, ofron të dhëna të cilat mund të analizohen më tutje, varësisht nga qëllimi i orientimit të politikave qeveritare.

Tabela 1. Nën sektorët e industrisë përpunuese sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit

Kodi	SEKTORI C - INDUSTRIA PËRPUNUESE	Numri i ndërmarrjeve	Numri i të punësuarve	Eksporti	Importi
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	1,244	6,153	34,588,451.58	430,684,698.03
11	Prodhimi i pijeve	89	1,822	27,565,225.96	78,580,037.59
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1	25	-	64,847,952.16
13	Prodhimi i tekstilit	127	817	6,136,824.19	58,660,751.55
14	Prodhimi i veshjeve	226	857	2,179,544.62	105,171,177.93
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	37	430	2,735,479.11	44,554,440.03
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës	445	1,390	5,408,715.00	69,299,228.65
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	97	430	2,420,018.61	58,497,122.07
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	159	586	-	430,172.03
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	7	62	1,344,980.72	393,716,432.70
20	Prodhimi i produkteve kimike	104	642	5,867,275.26	226,642,896.45
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	8	94	1,874,824.80	69,038,489.78
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	504	2,374	46,454,152.31	151,108,932.16

23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	478	3,796	7,843,754.76	166,279,334.09
24	Prodhimi i Metaleve	99	1,051	63,135,997.19	263,854,273.63
25	Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike	600	2,471	21,478,381.68	110,032,985.05
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	21	54	3,019,765.97	110,119,840.51
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	31	228	2,254,567.39	149,458,728.23
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	25	122	6,554,436.54	214,632,826.68
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	2	36	2,180,302.39	253,292,372.48
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	5	43	43,898.84	10,480,382.61
31	Prodhimi i mobilieve	406	2,314	10,541,831.77	49,638,936.13
32	Prodhimi tjetër p.k.t	88	819	4,623,853.10	42,744,366.08
33	Riparimi dhe instalimi I makinerive dhe pajisjeve	59	82	0.00	0.00
Total		4,862	26,698	258,252,281.79	3,121,766,376.62

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Politikat industriale përcaktojnë rëndësinë e indikatorëve të elaboruar me të dhënat për nën sektorët, në këtë raport. Nën sektori i përpunimit të produkteve ushqimore prinë për nga numri i ndërmarrjeve, punësimit dhe importit. Në këtë rast analizat tregojnë se ky nën sektor, mundë të zhvillohet më tutje duke u fokusuar në zëvendësimin e importit dhe rritjen e eksportit.

Nën sektori i përpunimit të produkteve ushqimore prinë me numrin më të madh të të punësuarve si dhe gjatë vitit 2018 ka shënuar rritje për 531 të punësuar, krahasuar me vitin paraprak. Po ashtu nën sektori “prodhimi i mobileve” ka shënuar rritje për 452 të punësuar, pasuar nga nën sektori i “prodhimi i produkteve të fabrikua metalike” me 235 të punësuar, i përcjellë nga nën sektori “prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me 208 të punësuar etj.

Nën sektori “prodhimi i mobileve” ka shënuar rritje në punësim, në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, por që duhet potencuar se rritja në përqindje është prej 24.27%, përderisa në numër kemi rritje për 452 të punësuar. Ndër nën sektorët tjerë, krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2018 ka rritje në punësim, për rreth 15% dhe në numër relativisht të mirë, me 111 të punësuar, është edhe nën sektori “prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës”.

Analiza e të dhënave të eksportit tregojnë se rritja më e lartë, në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, shikuar në vlerë monetare, është te nën sektori “prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës” me mbi 9 milion Euro, deri sa në përqindje kemi rritje për 25.24%. Në vendin e dytë radhitet nën sektori “prodhimi i produkteve të fabrikua metalike” me mbi 7 milion Euro, deri sa në përqindje ka treguar një rritje për 55.84%, pastaj radhitet nën sektori “prodhimi i pijeve” i cili nën sektor në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 ka pasur rritje në eksport për rreth 3

milion e 400 mijë Euro, i përcjellë nga nën sektori “prodhimi i mobileve” me rritje në eksport për rreth 3 milion e 400 mijë Euro.

Rënie të lartë në eksport në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, ka pasur nën sektori “prodhimi i metaleve” me një rënie në vlerë prej 20,171,155 Euro, apo shprehur në përqindje ka pasur rënie për 24.21%.


Nëse analizojmë importin mes nën sektorëve, kryesisht dominohen nga: prodhimi i koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës, prodhimi i metaleve, prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t., prodhimi i produkteve kimike etj.

1. Ndërmarrjet sipas nën sektorëve

Numri i ndërmarrjeve të nën sektorët prodhues ndikon në nxitjen e konkurrencës. Sa më i madh të jetë numri i ndërmarrjeve, konkurrenca do të jetë më e lartë, e cila do të nxisë cilësi, punësim, eksport etj.

Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, ndikojnë në qëndrueshmërinë ekonomike, megjithatë ndërmarrjet e mëdha kanë edhe rolin e vet pozitiv, pasi që janë më inovative dhe më konkurrenca në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.

Figura 1. Radhitja e nën sektorëve të sektorit C, sipas përqindjes në numër të ndërmarrjeve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI


Siç shihet në figurën e sipërme, për nga numri i ndërmarrjeve, me 25.59% prinë nën sektori “përpunimi i produkteve ushqimore”, ndërsa në vendin e dytë radhitet “prodhimi i produkteve të fabrikuarra metalike” me 12.34%. Një dallim i vogël vërehet edhe të katër nën sektorët tjerë, ku nën sektori i tretë me radhë është “prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës” me 10.37%, në vijim është nën sektori “prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me 9.83%,

pastaj radhitet nën sektori “prodhimi i drurit dhe produkteve të drurit dhe tapës” me 9.15%, i pasuar nga “prodhimi i mobileve me 8.35% etj.

2. Punësimi sipas nën sektorëve

Një ndër indikatorët i cili është analizuar në këtë raport dhe që është mjaftë i rëndësishëm, është punësimi. Sektori C- Industria përpunuese, sipas aktivitetit ekonomik, merr pjesë me 10.03%¹ në shkallën e punësimit. Nëse marrim për bazë edhe faktorët tjerë mundë të themi se nën sektorët prodhues kanë efekt “shumëzues” për krijimin e vendeve të punës në sektorët tjerë.

Figura 2. Punësimi sipas nën sektorëve të sektorit C



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Kontribut më të lartë në punësim, sipas figurës 2, ka treguar nën sektori “përpunimi i produkteve ushqimore” me 23.58%. Nën sektori i dytë me radhë është “prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me 14.55% të punësuar, nën sektori i tretë me radhë, i cili ndikon në punësim, është “prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike” me 9.47%, i përcjellë nga nën sektori “prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës” me 9.10% dhe nën sektori “Prodhimi i Mobileve” me 8.87% të punësuar në kuadër të sektorit C.


¹ Raport, Sektori C, Industria Përpunuese 2018, MTI – Departamenti i Industrisë

3. Eksporti sipas nën sektorëve

Zhvillimi i ndërmarrjeve në Kosovë, do të ndikoj në rritjen e eksporteve dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi.

Të dhënat e bilancit tregtarë në Kosovë, tregojnë se raporti i eksportit me importin, është në nivel shumë të ulët, por disa nga nën aktivitetet e pasqyruara në figurën 3, tregojnë potencial për t'u zhvilluar dhe për rritje të eksportit.

Figura 3. Eksportet sipas nën sektorëve të sektorit C




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Eksportet brenda Sektorit C, sipas figurës 3, dominohen nga nën sektori “prodhimi i metaleve” me 24.45%, ndërsa nën sektori i dytë me radhë për nga eksporti me 17.99% është nën sektori “prodhimi i produkteve prej gomës dhe plastikës”. Në vijim radhitet nën sektori “përpunimi i produkteve ushqimore” me 13.39%, i katërti me radhë është nën sektori “prodhimi i pijeve” me 10.67%, i përcjellë nga “prodhimi i produkteve të fabrikua metalike” me 8.32% etj.

4. Importi sipas nën sektorëve

Një ndër indikatorët e këtij raporti është edhe importi i produkteve të Sektorit C, ku Kosova vazhdon të ketë vlerë të lartë të importeve, duke paraqitur një bilanc të lartë negativ.

Figura 4. Importi sipas nën sektorëve të sektorit C



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Në kuadër të sektorit C, në import, prinë nën sektori “prodhimi i produkteve ushqimore” me 13.80% të importit, deri sa ky nën sektor në eksport radhitet i treti me 13.39%. Nën sektori i dytë me radhë, që merr pjesë në import me 12.61% është “prodhimi i koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës”, ndërsa në vendin e tretë është nën sektori “prodhimi i metaleve” me 8.45%, i përcjellë nga “prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio” me 8.11% etj.

PJESA E DYTË

KRAHASIMI I AKTIVITETEVE TË NËNSEKTORËVE

1. Prodhimi i tekstilit

Nën sektori i prodhimit të tekstilit në kuadër të industrisë përpunuese (sektorit C), për nga numri i ndërmarrjeve radhitet në vendin e nëntë, përderisa numri i të punësuarve si dhe eksporti radhitet në vendin e njëmbëdhjetë. Në totalin e sektorit C, importi i prodhimit të tekstilit radhitet në vendin e shtatëmbëdhjetë.

Tabela 2. Nën sektori i prodhimit të tekstilit sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit

Kodi	SEKTORI C - Prodhimi i tekstilit	Numri i ndërmarrjeve	Numri i të punësuarve	Eksporti	Importi
1399	Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t	50	205	12,672.65	911,988.84
1330	Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit	32	358	-	-
1320	Endja e tekstilit	11	77	511,127.80	15,814,106.35
1310	Përgatitja dhethurja e fijeve të tekstilit	10	13	509,170.62	1,123,102.91
1392	Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve	10	53	4,235,755.12	16,657,252.93
1391	Prodhimi i pëlhurave të thurura dhe të endura	6	13	5,091.96	4,367,193.11
1396	Prodhimi i tekstileve të tjera teknike dhe industriale	4	24	137,751.56	3,190,597.08
1393	Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve	3	3	703,760.14	11,220,597.64
1394	Prodhimi i litarëve, spangove dhe rrjetave	0	0	7,368.29	968,479.85
1395	Prodhimi i pëlhurave të pa endura dhe artikujve të pa endur, përveç veshjeve	1	4	14,126.05	4,407,432.84
Total		127	817	6,136,824.19	58,660,751.55

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Në kuadër të këtij nën sektori, me numër prej 50 ndërmarrjeve, prinë aktiviteti “Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t” dhe në vendin e dytë radhitet aktiviteti “Proceset përfundimtare të

përpunimit të tekstilit” me 32 ndërmarrje, përderisa aktivitete tjera kanë një përqindje më të vogël.

Në punësim prinë aktiviteti “Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit” me 358 të punësuar, në vendin e dytë radhitet aktiviteti “Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t”, me 205 të punësuar, ndërsa në vendin e tretë sa i përket punësimit radhitet aktiviteti “Endja e tekstilit” me 77 të punësuar.


Eksporti në nën sektorin e tekstilit, dominohet nga aktiviteti “Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve“, ndërsa në vendin e dytë është aktiviteti “Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve”.

Sa i përket krahasimit eksport dhe import në këtë nën sektor në përgjithësi aktivitetet kanë shënuar vlerë më të lart të importeve krahasuar me eksportet.

1.1 Ndërmarrjet sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit

Analizat e të dhënave për numrin e ndërmarrjeve në nën sektorin e tekstilit tregojnë se, për nga numri i ndërmarrjeve, në vendin e parë radhitet aktiviteti “Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t” me 39.37%, i pasuar nga “Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit” me 25.20% përderisa aktivitetet tjera përfaqësohen me një përqindje më të ulët në kuadër të këtij nën sektori.

Figura 5. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Sa i përket shtrirjes së këtyre ndërmarrjeve, të dhënat tregojnë se numri më i madh i ndërmarrjeve, është në aktivitetin “Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t”. Përqendrimi më i madh i ndërmarrjeve, të këtij aktiviteti, shtrihet në rajonin e Prishtinës, me 24%, pastaj në rajonin e Ferizajt me 20%, Prizrenit me 14% dhe Gjilani me 12%, ndërsa Peja, Mitrovica dhe Gjakova kanë të njëjtin numër të ndërmarrjeve me nga 10%.


Të dhënat tregojnë se aktiviteti “Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit”, ka pjesëmarrjen më të madhe në rajonin e Prishtinës, me 46.9%, pastaj në atë të Gjakovës me 15.6%, Mitrovicës me 12.5%, Prizreni me 9.4%, ndërsa Ferizaj dhe Gjilani kanë numër të njëjtë të ndërmarrjeve me 6.3% si dhe më së paku ka Peja me 3%.

Aktiviteti “Endja e tekstilit”, për nga numri i ndërmarrjeve ka një shtrirje vetëm në 4 rajone të Kosovës. Numri më i madh i ndërmarrjeve është në rajonin e Gjakovës, me 63.6%, pastaj në rajonin e Prishtinës me 18.2%, ndërsa Ferizaj dhe Mitrovica me nga 9.1%.

1.2 Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit

Në aktivitetet e nën sektorit të tekstilit, punësimi është i përqendruar më së tepërmi te “Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit” me 43.82%, pastaj kemi një përfshirje të punësuarve të aktiviteti “Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t” me 25.09% dhe aktiviteti “Endjen e tekstilit” me 9.42%.

Figura 6. Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përveç përqendrimit të punësuarve nëpër aktivitetet e nën sektorit të tekstilit, është analizuar edhe numri më i madh i të punësuarve në kuadër të aktiviteteve, nëpër rajonet e Kosovës.

Në kuadër të aktivitetit “Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit”, në rajonin e Gjakovës janë të punësuar 61.77%, në rajonin e Prishtinës 18.56%, në atë të Gjilanit 8.86%, në Ferizaj 7%, si dhe Prizreni dhe Mitrovica kanë një numër të punësuarve me nga rreth 2%, përderisa Peja nuk ka numër të punësuarve në këtë aktivitet.


Përfshirja më e madhe e numrit të punësuarve, në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t” prinë Prishtina me 43%, pastaj Mitrovica me 20%, Gjilani me 12%, Ferizaj me 11%, Gjakova me 9% të punësuar, ndërsa me pak ka në rajonin e Prizrenit me 4% dhe Pejës me 2%. Aktiviteti “Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve” ka një përfshirje më të madhe në rajonin e Gjilanit me 91% dhe Pejës me 9% përderisa në rajonet tjera nuk ka të punësuar.

1.3 Eksporti sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit

Eksporti i nën sektorit të prodhimit të tekstilit, është një indikatorë tjetër që është analizuar në këtë raport, pas atij të punësimit dhe numrit të ndërmarrjeve. Ky nën sektorë, krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, radhitet në vendin e njëmbëdhjetë.

Të dhënat për krahasimin e eksporteve të aktiviteteve brenda nën sektorit të tekstilit, tregojnë se me 69.02% prinë aktiviteti “Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve”, pastaj me 11.47% radhitet “Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve” dhe me 8.33%, aktiviteti “Endja e tekstilit”.

Figura 7. Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Eksporti të nën sektori i tekstilit është më i lartë me vendet e tjera, pastaj me vendet e BE-së, të CEFTA-së dhe më pak eksportohet në vendet e EFTA-së.

Aktiviteti “Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve” në vendet e BE-së eksporton 44.51%, në Vendet tjera 37.15%, në ato të CEFTA-së 16.05% dhe në vendet e EFTA-së 2.29% të produkteve.

Vendet në të cilat eksportohen më së tepërmi produktet e aktivitetit “Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve” janë: SHBA-ës 32.13%, në Gjermani 23.56%, në Shqipëri 9.05% etj.

Aktiviteti “Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve” eksportin e ka të përqendruar në vendet e CEFTA-së 93.76%, Vendet tjera 2.99%, vendet e EFTA-së 2.74% si dhe në vendet e BE-së me vetëm 0.51%.

Produktet e aktivitetit “Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve”, më së tepërmi eksportohen në Bosnjë dhe Hercegovinë, 31.04%, pastaj në Serbi 29.17%, në Maqedoni 20.42%, në Shqipëri 8.54% etj.

Aktiviteti “Endja e tekstilit”, eksportin më të madhe e ka në vendet e CEFTA-së, 62.75% pastaj, pothuajse të përgjysmuar, në vendet e BE-së 31.50%, në vendet e EFTA-së 3.85% si dhe në Vendet tjera vetëm 1.91%.


Vendet në të cilat eksporton më së tepërmi produktet e këtij aktiviteti janë: Shqipëria 36.15%, Bullgaria 29.01% dhe në Serbi 17.62%.

1.4 Importi sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit

Importi i nën sektorit të prodhimit të tekstilit krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, Sektori C, radhitet në vendin e shtatëmbëdhjetë.

Të dhënat për krahasimin e importit të aktiviteteve brenda nën sektorit të tekstilit, tregojnë se me 28.40% prinë aktiviteti “Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve”, pastaj me 26.96% radhitet aktiviteti “Endja e tekstilit” si dhe “Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve” me 19.13%, në import.

Figura 8. Importet sipas aktiviteteve të nën sektori i tekstilit



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Importi i aktivitetit “Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve”, 86.83 % është nga Vendet e tjera, 7.48% nga vendet e CEFTA-së, 5.47 %, nga vendet e BE-së dhe nga vendet e EFTA-së, me një përqindje mjaftë të ulët, vetëm 0.21 %.

Sa i përket aktivitetit “Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve”, vendet ku është i përqendruar importi janë: Kina, 42.83%, pastaj Turqia, 32.94% dhe India 4.53%.

Aktiviteti “Endja e tekstilit”, importin e ka të përqendruar te Vendet tjera në vlerë prej 86.68%, nga vendet e BE-së 11.46% dhe nga vendet e CEFTA-së vetëm 1.84%.

Vendet nga të cilat importohen këto produkte janë: Turqia me 42.36%; Kina me 40.29 %; Mbretëria e Bashkuara me 2.60%, Italia me 1.93% etj.

Produktet e aktivitetit “Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve” importin e ka të përqendruar nga Vendet tjera në vlerë prej 81.84%, nga vendet e BE-së 16.27%, nga vendet e CEFTA-së 1.49% si dhe nga vendet e EFTA-së 0.40%.

Vendet nga të cilat më së tepërmi importohet ky produkt janë: nga Turqia 77.05%, nga Belgjika me 8.70%, dhe Holanda me 4.96%.

2. Prodhimi i veshjeve

Nën sektori i prodhimit të veshjeve në kuadër të Industrisë përpunuese (Sektorit C), sa i përket numrit të ndërmarrjeve zë vendin e shtatë si dhe me numër të punësuarve radhitet në vendin e nëntë. Ky nën sektor radhitet në vendin e njëzetë, sa i përket eksportit, ndërsa importi radhitet në vendin e dymbëdhjetë.

Tabela 3. Nën sektori i prodhimit të veshjeve sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit

Kodi	SEKTORI C - Prodhimi i veshjeve	Numri i ndërmarrjeve	Numri i të punësuarve	Eksporti	Importi
1413	Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme	126	494	1,073,648.55	42,467,790.89
1412	Prodhimi i veshjeve të punës	32	158	159,970.75	1,042,102.47
1419	Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)	31	109	485,392.88	12,711,496.03
1439	Prodhimi i rrobave të tjera të thurura ose të punuara me grep	28	26	169,967.31	11,400,201.43
1431	Prodhimi i qorapeve të thurura	5	12	67,273.06	5,684,634.23
1411	Prodhimi i veshjeve të lëkurës	3	55	231.10	160,788.65
1414	Prodhimi i veshjeve të brendshme	1	3	223,060.97	31,678,476.32
1420	Prodhimi i artikujve nga gëzofi	0	0	-	25,687.91
Totali		226	857	2,179,544.62	105,171,177.93

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Në kuadër të këtij nën sektori, aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme”, në krahasim me aktivitetet tjera, prinë si për nga numri i ndërmarrjeve, numri i të punësuarve si dhe në eksport dhe import.

Ky aktivitet, “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme”, në krahasim me aktivitetet tjera, në kuadër të këtij nën sektori, në eksport merr pjesë me 49.26%, ndërsa në import merr pjesë me 40.38%.


Eksporti i produkteve të aktivitetit “Prodhimi i veshjeve të brendshme” radhitet në vendin e tretë me 10.23%, ndërsa importi i produkteve të këtij aktiviteti radhitet në vendin e dytë, me 30.12%.

Aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)” në kuadër të këtij nën sektori, në eksport merr pjesë me 22.27%, krahasuar me aktivitetet tjera ndërsa në import merr pjesë me 12.09%.

2.1 Ndërmarrjet sipas aktiviteteve të nën sektori i veshjeve

Analizat e të dhënave, për numrin e ndërmarrjeve, për nën sektorin e Prodhimit të veshjeve tregojnë se, për nga numri i ndërmarrjeve, në vendin e parë radhitet aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme” me 55.75%, i pasuar nga “Prodhimi i veshjeve të punës” me 14.16%. Aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)” radhitet në vendin e tretë me 13.72%.

Figura 9. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektori i veshjeve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Sa i përket shtrirjes së këtyre ndërmarrjeve, të dhënat tregojnë se numri më i madhe i ndërmarrjeve, në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme” shtrihet në rajonin e Prishtinës, me 27%, pastaj në rajonin e Gjakovës, me 21%. Një shtrirje e përafërt e ndërmarrjeve është në rajonin e Prizrenit me 20%, pastaj në regjionin e Mitrovicës me 10% pasuar nga Gjilani me 9%, Ferizaj me 7% dhe Peja me 6%.


Të dhënat tregojnë se aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të punës”, ka shtrirjen më të madhe në rajonin e Ferizajt dhe Gjakovës, me një përqindje të njëjtë me nga 19%, gjithashtu rajoni i Pejës dhe Mitrovicës me nga 16%, pastaj në atë të Prishtinës me 12.50%, ndërsa një numër më i ulët i ndërmarrjeve është shënuar në regjionin e Prizrenit dhe Gjilanit, me nga 9%.

Aktiviteti që ka të bëjë me “Prodhimin e veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)” për nga numri i ndërmarrjeve ka një shtrirje më të madhe në rajonin e Prishtinës me 35.48%, pastaj e kemi rajonin e Prizrenit dhe Gjilanit me nga 16%, atë të Ferizajt dhe Gjakovës me nga 10%, ndërsa përqindje më të vogël ka Peja dhe Mitrovica, me nga 6%.

2.2 Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektorit të veshjeve

Në aktivitetet e nën sektorit të veshjeve, punësimi është i përqendruar më së tepërmi te “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme” me 57.64%, pastaj kemi një përfshirje të punësuarve te “Prodhimi i veshjeve të punës”, me 18.44% dhe një numër prej 12.72%, të punësuar, e kemi te aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)”.

Figura 10. Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektorit të veshjeve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përveç përqendrimit të punësuarve nëpër aktivitetet e nën sektorit të prodhimit të veshjeve kemi analizuar edhe shtrirjen e këtyre aktiviteteve nëpër rajonet e Kosovës. Analizat tregojnë se në aktivitetin “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme” përfshirja më e madhe e të punësuarve është në rajonin e Prishtinës, me 37%, pastaj atë të Gjakovës me 31%, Prizrenit me 12%, në rajonin e Gjilanit me 10%, atë të Ferizajt me 7%, pasuar nga Peja me 3% dhe në atë të Mitrovicës me vetëm 0.6%.

Në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i veshjeve të punës” përfshirja më e madhe e numrit të punësuarve është në rajonin e Pejës, me 44%, atë të Gjakovës me 33%, pastaj Prishtina me 9%

ndërsa më pak ka në rajonin e Prizrenit dhe Gjilanit me nga 4% si dhe në atë të Ferizajt dhe Mitrovicës me nga 3%.


Përfshirja më e madhe e numrit të punësuarve, në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)” është në rajonin e Pejës me 66%, Prishtinës me 13%, Prizrenit me 8.26%, Gjilanit me 7%, pastaj një përfshirje më e vogël është në atë të Ferizajt me 3%, Gjakovës me 2% dhe në rajonin e Mitrovicës me 1%.

2.3 Eksporti sipas aktiviteteve të nën sektori i veshjeve

Eksporti i nën sektorit të prodhimit të veshjeve, është një indikatorë tjetër që është analizuar në këtë raport, pas atij të punësimit dhe numrit të ndërmarrjeve, krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, radhitet në vendin e njëzetë.

Krahasimi i të dhënave të eksporteve për aktivitetet, brenda nën sektorit të prodhimit të veshjeve, tregojnë se me 49.26% prinë aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme”, pastaj me 22.27% radhitet “Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)”, si dhe aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të brendshme” me 10.23%.

Figura 11. Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i veshjeve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përqendrimi më i madhe i eksporteve të Kosovës për prodhimet e produkteve të veshjeve, në kuadër të aktiviteteve të këtij nën sektori është në vendet e BE-së, vendet tjera, vendet e CEFTA-së si dhe më pak eksportohen në vendet e EFTA-së.

Produktet e aktivitetit që përfshinë “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme” eksportohen në vendet e BE-së prej 73.53%, në Vendet tjera me 13.39%, në vendet e CEFTA-së me 8.11% dhe vetëm 4.97% në vendet e EFTA-së.

Vendet në të cilat eksportohen më së tepërmi “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme” janë: në Holandë me 34.90%, në Itali me 23.43%, në Gjermani me 11.99%, etj.

Aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)” eksportin e ka të përqendruar në vendet e CEFTA-së me 75.71%, në Vendet tjera me 15.13%, në vendet e BE me 6.26% dhe në vendet e EFTA-së me 2.89%.


Vendet në të cilat eksportohet më së tepërmi produktet e këtij aktiviteti janë: në Mali të Zi me 29.78% pastaj në Maqedoni me 24.82%, në Shqipëri 19.11% dhe në Turqi me 15.13%.

Produktet e aktivitetit “Prodhimi i veshjeve të brendshme” me 38.11% eksporton në vendet e CEFTA-së, me 29.38% në vendet e EFTA-së, me 24.26% në vendet e BE-së si dhe me 8.25% në Vendet tjera. Vendet në të cilat eksportohen produktet e këtij aktiviteti janë: Zvicra me 29.38% pastaj në Shqipëri me 14.46%, në Gjermani me 13.29% dhe në Malin e Zi me 12.43%.

2.4 Importi sipas aktiviteteve të nën sektori i veshjeve

Importi të nën sektori i prodhimit të veshjeve, krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, Sektori C, radhitet në vendin e dymbëdhjetë. Nëse krahasojmë importin e aktiviteteve brenda nën sektorit të prodhimit të veshjeve, prinë aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme” me 40.38%, pastaj radhitet “prodhimi i veshjeve të brendshme” me 30.12 %, dhe “Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)”, me 12.09%.

Figura 12. Importi sipas aktiviteteve të nën sektori i veshjeve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Importi i Produkteve të aktivitetit “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme”, dominohet nga Vendet e tjera me 88.41%, vendet e BE-së me 8.39%, vendet e FFTA-së me 2.33% ndërsa vendet e CEFTA-së me 0.87%.

Sa i përket importit të produkteve të aktivitetit “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme” kryesisht është i përqendruar nga Turqia, me 45.48%, nga Kina me 20.36%, nga Bangladeshi me 11.61%, nga Vietnami me 2.61% etj.

Importi i produkteve të aktivitetit “Prodhimi i veshjeve të brendshme”, dominohet nga vendet e tjera me 91.5 %, nga vendet e BE-së me 6.41%, nga vendet e CEFTA-së me 1.89% dhe nga vendet e EFTA-së vetëm me 0.20%

Sa i përket vendeve, importi i këtij aktiviteti kryesisht është i përqendruar nga Turqia me 52.98%, nga Kina me 14.67 %, nga Bangladeshi me 13.73 %, nga Pakistani me 1.93% etj.

Në import, aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)” prinë vendet tjera me 91.36%, pastaj renditen vendet e BE-së me 7.02%, vendet e CEFTA-së me 1.27% dhe vendet e EFTA-së me 0.36%.

Vendet nga importohet më shumë nga ky aktivitet janë : nga Kina me 39.84%, nga Turqia me 36.15%, nga Bangladeshi me 5.11%, nga Kamboxhia me 3.37%.

3. Prodhimi i Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës

Nën sektori i prodhimit të lëkurës dhe produkteve prej lëkurës, në kuadër të Industrisë përpunuese-Sektori C, për nga numri i ndërmarrjeve radhitet në vendin e gjashtëmbëdhjetë, me numër të punësuarve në vendin e katërmëdhjetë, ndërsa sa i përket eksportit radhitet në vendin e gjashtëmbëdhjetë kurse në import në vendin e njëzetë.

Tabela 4. Nën sektori i prodhimit të lëkurës sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit

Kodi	SEKTORI C - Prodhimi i lëkurës	Numri i ndërmarrjeve	Numri i të punësuarve	Eksporti	Importi
1520	Prodhimi i këpucëve	24	395	1,779,019.52	35,696,467.67
1512	Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjëseneve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve	11	31	924,736.75	7,870,335.00
1511	Tanimi dhe regjja e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit	2	4	31,722.84	987,637.36
Total		37	430	2,735,479.11	44,554,440.03

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Në kuadër të këtij nën sektori, aktiviteti “Prodhimi i këpucëve”, në krahasim me aktivitetet tjera, prinë në të gjitha fushat, si për nga numri i ndërmarrjeve po ashtu edhe për nga numri i të punësuarve, gjithashtu edhe në eksport, me 65.04 % dhe në import me 80.12%.

Aktiviteti ”Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjëseneve të ngjashme, si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve” në totalin e eksportit të këtij nën sektori, merr pjesë me 33.81% përderisa në import merr pjesë me 17.66%.


Aktiviteti “Tanimi dhe regjja e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit” në totalin e eksportit të këtij nën sektori, merr pjese me 1.16 % ndërsa në import me një përqindje prej 2.22%.

3.1 Ndërmarrjet sipas aktiviteteve të nën sektori i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës

Analiza e të dhënave në nën sektorin Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure, tregon se për nga numri i ndërmarrjeve, në vendin e parë radhitet aktiviteti “Prodhimi i këpucëve” me 64.86%, i pasuar nga “Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjëseneve të ngjashme si takëmeve

të kuajve dhe parzmoreve” me 29.73%, si dhe aktiviteti i radhës “Tanimi dhe regjja e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit”, me 5.41%.

Figura 13. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të lëkurës dhe produkteve të lëkurës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Sa i përket shtrirjes së këtyre ndërmarrjeve, të dhënat tregojnë se numri më i madhe i ndërmarrjeve, në kuadër të aktivitetit “Prodhiimi i këpucëve”, shtrihet në rajonin e Prizrenit me 50%, Prishtinës me 17%, Ferizajt dhe Pejës me nga 13%, pastaj në rajonin e Gjilanit dhe Mitrovicës me nga 4%, ndërsa në Gjakovë nuk ka ndërmarrje.


Të dhënat tregojnë se aktiviteti “Prodhiimi i valixheve, çantave dhe gjëseneve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve” radhitet e dyta dhe ka shtrirjen më të madhe në rajonin e Prishtinës me 36.36%, pastaj në atë të Pejës me 27.27% si dhe Prizrenit 18.18%, në Ferizaj dhe Gjilan me nga 9%, ndërsa në regjionin e Mitrovicës dhe Gjakovës nuk ka ndërmarrje.

Aktiviteti që ka të bëjë me “Tanimi dhe regjja e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit” ka shtrirje vetëm në dy rajone të Kosovës, atë të Mitrovicës dhe të Gjakovës me nga 50%.

3.2 Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës

Në aktivitetet e nën sektorit Prodhiimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës, punësimi është i përqendruar më së tepërmi te aktiviteti “Prodhiimi i Këpucëve” me 91.86%, pastaj kemi një përfshirje të punësuarve të “Prodhiimi i valixheve, çantave dhe gjëseneve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve” me 7.21% dhe me një numër më të vogël të punësuarve ka aktiviteti “Tanimi dhe regjja e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit” me 0.93%.

Figura 14. Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të lëkurës dhe produkteve të lëkurës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përveç përqendrimit të punësuarve nëpër aktivitetet e nën sektorit të Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure, kemi analizuar edhe shtrirjen e këtyre aktiviteteve nëpër rajonet e Kosovës.

Përderisa në aktivitetin “Prodhimi i këpucëve” ishin të punësuar 91.86% punëtorë, analizat tregojnë se përfshirja më e madhe e këtyre të punësuarve është në rajonin e Prizrenit me 56.2%, pastaj në atë të Ferizajt me 18.73%, atë të Pejës me 15.44%, Mitrovicës me 9%, Prishtinës me vetëm 1%, ndërsa në Gjilan dhe Gjakovë nuk ka të punësuar në këtë aktivitet.

Në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjëseneve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmëve” përfshirja më e madhe e numrit të punësuarve është në rajonin e Prishtinës me 67.74%, pastaj atë të Ferizajt me 25.81% më pak ka në Pejë dhe Gjilan me nga 3%, ndërsa në regjionet tjera nuk ka të punësuar.

Aktiviteti që ka të bëjë me “Tanimi dhe regjia e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit” ka shtrirje vetëm në rajonin e Gjakovës me 75% dhe atë të Mitrovicës, me 25%.


3.3 Eksporti sipas aktiviteteve të nën sektori i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës

Eksporti i nën sektorit të Prodhimit të lëkurës dhe produkteve prej lëkure, është indikator tjetër që është analizuar në këtë raport pas atij të punësimit dhe numrit të ndërmarrjeve. Ky nën

sektor, nëse e krahasojmë me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, radhitet në vendin e gjashtëmbëdhjetë.

Eksporti i produkteve të aktiviteve brenda nën sektorit të Prodhimit të lëkurës dhe produkteve prej lëkure, tregon se me 65.04% prinë aktiviteti “Prodhimi i Këpucëve”, pastaj me 33.81%, radhitet “Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjëseneve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve” dhe në vendin e tretë është “Tanimi dhe regjja e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit” me 1.16%.

Figura 15. Eksportet sipas aktiviteve të nën sektori i prodhimit të lëkurës dhe produkteve të lëkurës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përqendrimi më i madhe i eksporteve të produkteve, në kuadër të aktiviteve të këtij nën sektori, është në vendet e BE-së, pastaj ato të CEFTA-së dhe vendeve tjera, për deri sa shumë më pak eksportohet në vendet e EFTA-së.

Aktiviteti që përfshinë produktet “Prodhimi i Këpucëve”, eksportohen në vendet e BE-së me 68.54 %, në vendet e CEFTA-së me 27.35%, ndërsa në vendet tjera me 4.07%, shumë më pak eksportohet në vendet e EFTA-së, me vetëm 0.04%.

Vendet në të cilat eksportohen produktet e aktivitetit “Prodhimi i Këpucëve” janë: në Francë 36.14%, në Itali 14.46%, në Kroaci 11.56% etj.

Aktiviteti “Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjëseneve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve”, eksportin e ka të përqendruar në vendet e BE-së, kryesisht në Francë 50.66%, pastaj në Itali 33.64%, në Rumani 12.13% etj.


Produktet e aktivitetit “Tanimi dhe regjja e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit” më së tepërmi eksportohen në vendet e CEFTA-së, si në Serbi 88.55% dhe në vendet e BE-së, në Austri me 8.05% dhe në Itali me 3.40%.

3.4 Importi sipas aktiviteteve të nën sektori i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës

Importi i produkteve të nën sektori Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej saj, krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, radhitet në vendin e njëzetë.

Nëse krahasojmë importin e produkteve të aktiviteteve në kuadër të këtij nën sektori, me 80.12% prinë aktiviteti i “Prodhimit i këpucëve”, pastaj “Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjëseneve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve” me 17.66 %, dhe “Tanimi dhe regjja e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit” me 2.22%.

Figura 16. Importet sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të lëkurës dhe produkteve të lëkurës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përqendrimi më i madhe i importeve të produkteve në Kosovë, në kuadër të aktiviteteve të këtij nën sektori është nga vendet tjera, pastaj nga ato të BE-së dhe CEFTA-së, shumë pak importohet nga vendet e EFTA-së.

Produktet e aktivitetit “Prodhimi i Këpucëve”, importohen nga vendet e tjera me 89.22%, nga vendet e BE-së me 7.02 %, nga vendet e CEFTA-së me 3.71 % dhe nga vendet e EFTA-së me 0.06%.

Vendet nga të cilat Importohen më së tepërmi, produktet e aktivitetit “Prodhimi i Këpucëve” janë: nga Kina 41.35%, nga Turqia 24.72%, nga Vietnami 12.52% dhe nga Indonezia me 5.52%.

Aktiviteti “Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjëseneve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve”, Importin e ka të përqendruar në vendet tjera, kryesisht nga Kina me 57.7%, nga Turqia 30.28%, dhe nga Italia 2.54%.

Aktiviteti që përfshinë “Tanimi dhe regjja e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit” importin e ka të përqendruar nga vendet e BE-se, nga Italia me 93.69%, dhe nga vendet tjera, siç është Turqia me 2.31% pastaj nga Tailanda me 1.33% etj.

4. Prodhimi i Drurit dhe i Produkteve të Drurit dhe të Tapës, përveç Mobilieve, Prodhimi i Artikujve nga Kashta dhe Materialeve të Gërshetuara-Thurëse

Ky nën sektor përfshin prodhimin e produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobileve, prodhimin e artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse. Më konkretisht kjo ndarje përfshinë prodhimin e produkteve të drurit, kompensatë, rimeso, enë druri, dysheme drurit, mbërthese druri dhe objekte druri të pa fabrikuar. Proceset e prodhimit përfshijnë sharrimin, planifikimin, formësimin, petëzimin dhe montimin e produkteve të drurit, duke filluar nga lëndët drusore të prera, ose formësimet nga mjetet tjera formuese. Lëndë drusore ose forma të tjera të drurit të shndërruara gjithashtu, të cilat mund të planifikohen ose zbuten dhe të grumbullohen në produkte të përfunduara, siç janë kontejnerët prej druri.²

Nën sektori i prodhimit të drurit, në kuadër të industrisë përpunuese (sektorit C), në punësim zë vendin e shtatë, për nga numri i ndërmarrjeve radhitet në vendin e pestë. Ky nën sektor në eksport radhitet në vendin e njëmbëdhjetë dhe në import radhitet në vendin e katërmëdhjetë.

Tabela 5. Nën sektori i prodhimit të drurit dhe produkteve prej drurit dhe të tapës, përveç mobileve sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit

Kodi	SEKTORI C - Prodhimi i drurit dhe produkteve prej drurit dhe të tapës	Numri i ndërmarrjeve	Numri i të punësuarve	Eksporti	Importi
1610	Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtaria	120	333	551,831.93	13,192,537.20
1621	Prodhimi i fletëzave të rimesos dhe të paneleve bazuar në dru (furniri)	7	19	170,434.01	40,376,396.58
1622	Prodhimi i parketit për dysheme	3	8	19,715.00	1,504,235.44
1623	Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese	239	787	2,920,237.59	11,229,283.79
1624	Prodhimi i kontejnerëve nga druri	4	11	970,303.33	635,704.26
1629	Prodhimi i produkteve të tjera nga druri; prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse	72	232	776,193.14	2,361,071.38
Total		445	1,390	5,408,715.00	69,299,228.65

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Aktiviteti “Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese” prinë me numër të ndërmarrjeve, punësim dhe eksport, krahasuar me aktivitetet tjera.

² Raport, Sektori C, Industria Përpunuese 2018, MTI – Departamenti i Industrisë


Aktiviteti i cili ka raport më të mirë në eksport, krahasuar me importin edhe pse me vlerë, nën një milion, është aktiviteti “Prodhimi i kontejnerëve nga druri”, derisa eksport shumë të ulët krahasuar me importin, ka aktiviteti “Prodhimi i parketit për dysheme”.

Në shkëmbim tregtar, brenda nën sektorit të drurit dhe produkteve prej drurit dhe të tapës, përveç mobileve, eksporti merr pjesë me 7.24%, deri sa importi merr pjesë me 92.76%.

4.1 Ndërmarrjet sipas aktiviteteve të nën sektorit të drurit

Analiza e të dhënave të aktiviteteve të nën sektorit të drurit, tregon se për nga numri i ndërmarrjeve prinë “Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese” me 53.71%, pasuar nga aktiviteti “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtarisë” me 26.97% dhe në vendin e tretë për nga numri i ndërmarrjeve, te ky nën sektorë radhitet aktiviteti “Prodhimi i produkteve të tjera nga druri, prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialet e gërshetuara-thurëse” me 16.18%.

Figura 17. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektorit të prodhimit të drurit



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Për nga shtrirja rajonale e numrit të ndërmarrjeve, te aktiviteti “Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese”, prinë rajoni i Prishtinës me 20.08%, rajoni i dytë me radhë është Prizreni me 16.74%, pastaj radhitet rajoni i Gjilanit me 14.64%, rajoni i Pejës me 13.81%, rajoni i Gjakovës me 13.39%, rajoni i Ferizajt me 12.13% dhe rajoni i Mitrovicës me 9.21%.


Aktiviteti “Sharrimit të drurit dhe zdrukthëtarisë”, ka shtrirje të ndërmarrjeve me diferencë jo aq të lartë në mes të rajoneve. Në këtë aktivitet prinë rajoni i Gjakovës me 19.17% të ndërmarrjeve, pastaj radhitet rajoni i Prishtinës me 16.67%, rajoni i Gjilanit dhe Mitrovicës me nga 15%, i pasuar nga rajoni i Prizrenit me 12.50%, rajoni i Pejës me 11.67% dhe rajoni i Ferizajt me 10%.

Të dhënat tregojnë se aktiviteti “Prodhimi i produkteve të tjera nga druri, prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialet e gërshetuara-thurëse”, është i përqendruar në rajonin e Prishtinës me 23.61%, i pasuar nga rajoni i Ferizajt me 16.67%, rajoni i Gjakovës 15.28%, rajoni i Pejës dhe Gjilanit me 13.89%, rajoni i Mitrovicës me 9.72% dhe rajoni i Prizrenit me 6.94%.

4.2 Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i drurit

Nën sektori i drurit, punësimin e ka të përqendruar, te aktiviteti “Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese”, me 56.62%, pastaj aktiviteti “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtarisë” me 23.96% dhe aktiviteti i tretë me radhë për nga punësimi në kuadër të nën sektorit të drurit është aktiviteti “Prodhimi i produkteve të tjera nga druri, prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialit të gërshetuar –thurje” me 16.69%.

Figura 18. Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të drurit



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Krahasimi në punësim, i shpërndarë në rajone, dallon sipas aktiviteteve. Aktiviteti “Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese”, prinë në rajonin e Mitrovicës me 24.40%, pastaj radhitet rajoni i Pejës me 19.19%, rajoni i tretë me radhë është ai i Prishtinës me 13.47%, pastaj rajoni i Prizrenit me 12.71%, rajoni i Ferizajt me 11.94%, i Gjakovës me 10.55% dhe rajoni i Gjilanit me 7.75%, të punësuar.

Numri i të punësuarve të aktiviteti “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtarisë”, është më i madhe në rajonin e Prishtinës me 24.92%, pastaj në rajonin e Gjakovës me 17.12%, në rajonin e Gjilanit

dhe Mitrovicës me nga 15%, në rajonin e Prizrenit 11.11% dhe në rajonin e Ferizajt dhe Pejës me nga rreth 8%.


Në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i produkteve të tjera nga druri, prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialet e gërshetuara-thurje”, numri i të punësuarve sipas regjioneve është: Gjakova me 24.57%, Ferizaj me 21.12%, Prishtina me 16.81%, Peja me 15.95%, Gjlani me 14.22% dhe me nga nën 5%, Mitrovica dhe Prizreni.

4.3 Eksporti sipas aktiviteteve të nën sektori i drurit

Njëri ndër indikatorët e analizuar në këtë raport është edhe eksporti. Nën sektori i drurit krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, radhitet në vendin e njëmbëdhjetë me 2.09%, në eksportet e produkteve në totalin e eksporteve të sektorit C.

Nëse krahasojmë eksportin e aktiviteteve në kuadër të nën sektorit të drurit, në totalin e eksportit të këtij nën sektori, aktiviteti “Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese”, merr pjesë me 53.99%, pastaj radhitet “Prodhimi i kontejnerëve nga druri” me 17.94%, “Prodhimi i produkteve të tjera nga druri; prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialet e gërshetuara-thurje” me 14.35%, “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtarisë” me 10.20% etj.

Figura 19. Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të drurit



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Nën sektori i drurit, në eksport është i përqendruar kryesisht në vendet e EFTA-së me 45.60%, pastaj radhiten vendet e BE-së me 25.09%, CEFTA-së me 28.32% dhe me eksport shumë të vogël në vendet tjera me 0.98%.

Eksportin më të lartë të produkteve të aktivitetit “Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese”, Kosova e ka në vendet e EFTA-së me 67.70%, konkretisht në Zvicër me 67.20%, pastaj në vendet e BE-së me 24.53%, (Gjermani me 10.98%, Suedi 5.80% etj) në vendet e CEFTA-s me 6.14% dhe në vendet tjera 1.63%.

Produktet e aktivitetit “Prodhimi i kontejnerëve nga druri”, eksportohen kryesisht në vendet e CEFTA-së, me 65.22%, si dhe në vendet e BE-së me 34.68%.

Vendet në të cilat Kosova eksporton më shumë produkte nga aktiviteti “Prodhimi i kontejnerëve nga druri” janë eksportuar në: Serbi me 57.7%, Slloveni me 21.72%, Gjermani me 7.17%, Shqipëri me 5.59% etj.

Aktiviteti i tretë me radhë, për nga vlera e eksporteve, të nën sektori i drurit, është “Prodhimi i produkteve të tjera nga druri, prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialeve të gërshetuara thurje”. Produktet e këtij aktiviteti me 51.80%, eksportohen në vendet e EFTA-së, me përqendrim në Zvicër, pastaj radhiten vendet e BE me 34.77%, vendet e CEFTA-së 12.94% dhe vendet tjera me përqindje shumë të ulët me vetëm 0.49%. Ky aktivitet eksportin e ka të përqendruar në Zvicër me 51.30%, pastaj në Gjermani me 21.43%, Shqipëri me 6.94% etj.

Aktiviteti “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtarisë” është njëri ndër aktivitetet i cili merr pjesë me 10.20%, në kuadër të nën sektorit të drurit në eksport. Në kuadër të këtij aktiviteti eksporti është i përqendruar në vendet e CEFTA-së me 87.46%, derisa me vendet e EFTA-së është 10%, kurse në vendet e BE-së me 2.33% dhe vendet tjera me vetëm 0.21%.


Eksportin më të lartë Kosova në këtë aktivitet e ka në Shqipëri me 68.93%, pastaj në Serbi me 17.04%, Zvicër me 10% etj.

4.4 Importi sipas aktiviteteve të nën sektori i drurit

Pas analizës së ndërmarrjeve, punësimit dhe eksporteve të nën sektorit të drurit, krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, në këtë raport është analizuar edhe importi. Në totalin e importit të industrisë përpunuese (sektorit C), nën sektori i drurit radhitet në vendin e katërbëdhjetë me 2.22%.

Në kuadër të aktiviteteve të nën sektorit të drurit, në import, prinë aktiviteti “Prodhimi i fletëzave të rimesos dhe të paneleve bazuar në dru (funir)” me 58.26%, pastaj radhitet aktiviteti “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtarisë” me 19.04% dhe aktiviteti i tretë me radhë me 16.20% është “Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese”.

Figura 20. Importet sipas aktiviteteve të nën sektorit të prodhimit të drurit



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Në kuadër të nën sektorit të drurit, importi po thuaj se është me shpërndarje të njëjtë. Importi në vendet e BE-së është 35.71%, vendet e CEFTA-së, 32% dhe vendet tjera 30.29%, deri sa nga vendet e EFTA-së, është vetëm 2%.

Importi i produkteve të aktivitetit “Prodhim i fletëzave të rimesos dhe të paneleve bazuar në dru (funir)”, nga vendet e BE-së është 42.72%, nga vendet e tjera 36.82%, vendet e CEFTA-së 17.93% dhe nga vendet e EFTA-së 2.54%.

Vendet nga të cilat më shumë importohen produktet e aktivitetit “Fletëza të rimesos dhe të paneleve bazuar në dru (funir)”, janë: Turqia 27.28%, Gjermania 22.15%, Serbia 16.17% etj.

Aktiviteti “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtarisë”, është i dyti me radhë, sa i përket importit, në kuadër të nën sektorit të drurit. Importet e produkteve të këtij aktiviteti kryesisht janë nga vendet e CEFTA-së me 95.02%, nga vendet e BE-së me 4.55%, deri sa vendet e EFTA-së dhe vendet tjera, marrin pjesë vetëm me nga 0.40%.

Vendet kryesore nga të cilat Kosova importon produktet e këtij aktiviteti janë: Mali i Zi 59.13%, Bosnja 30.7%, Serbia 5.17% etj.

Në kuadër të nën sektorit të drurit, importi ndikohet mjaft edhe nga aktiviteti “Prodhim i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese”. Te ky aktivitet, në import dominojnë vendet e BE-së me 46.32% dhe vendet tjera me 42.06%, derisa importi nga vendet e CEFTA-së është 9.06% dhe nga vendet e EFTA-së vetëm 2.56%.

Vendet nga të cilat importohen më shumë produktet e këtij aktiviteti janë: Kina me 24.10%, pastaj nga Turqia me 17.79%, nga Gjermania 15.27%, Bosnja dhe Hercegovina 5.91% etj.

5. Prodhimi i Letrës dhe Produkteve prej Letrës

Të dhënat e nën sektorit Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës, tregojnë se ky nën sektor, në Kosovë, mundë të zhvillohet dhe të ndikoj në punësim, pasi që mesatarja e punësimit në një ndërmarrje është rreth 5 të punësuar. Mundësitë për zhvillim të këtij nën sektori i shohim edhe te tabela 6, ku importi është mjaft i lartë krahasuar me eksportin. Në raportin e shkëmbimit tregtar (eksport/import) eksporti merr pjesë me vetëm 3.97%, deri sa importi është 96.03%.

Krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese (sektorit C), ky nën sektor, në punësim zë vendin e katëmbëdhjetë, në eksport vendin e pesëmbëdhjetë, derisa në import zë vendin e tetëmbëdhjetë.

Tabela 6. Nën sektori i prodhimit të letrës sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit

Kodi	SEKTORI C - Prodhimi i letrës	Numri i ndërmarrjeve	Numri I të punësuarve	Eksporti	Importi
1711 1712	Prodhimi i brumit të letrës, letrës dhe kartonit	15	42	210,940.22	20,811,670.21
1721	Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit	20	139	1,666,324.86	10,114,338.37
1722	Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit	31	173	66,514.35	22,955,400.67
1723	Prodhimi i materialit prej letrës për zyre	12	17	124,093.90	2,233,534.83
1724	Prodhimi i tapetave të mureve	2	4	14,900.17	319,116.91
1729	Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t.	17	55	337,245.11	2,063,061.08
Total		97	430	2,420,018.61	58,497,122.07

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI


Aktiviteti “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit”, për nga numri i ndërmarrjeve dhe punësimit, radhitet në vendin e parë, në kuadër të nën sektorit të letrës dhe produkteve prej letrës.

Në eksport aktiviteti “Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit” dhe aktiviteti “Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t.” qëndrojnë më mirë krahasuar me aktivitetet tjera brenda këtij nën sektori.

5.1 Ndërmarrjet sipas aktiviteteve të nën sektori i letrës dhe produkteve prej letrës

Te nën sektori i letrës, për nga numri i ndërmarrjeve prinë aktiviteti “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit”, me 31.96%, krahasuar me aktivitetet tjera brenda këtij nën sektori. Aktiviteti i dytë është “Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit”, me 20.62%, ndërsa aktiviteti i tretë, për nga numri i ndërmarrjeve, është “Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t” me 17.52%.

Figura 21. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektori i letrës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Shikuar në totalin e numrit të ndërmarrjeve, te nën sektori i letrës, prinë rajoni i Prishtinës, i pasuar nga rajoni i Prizrenit, Ferizajt etj.

Të dhënat tregojnë se sipas aktiviteteve të nën sektorit të letrës, shpërndarja e numrit të ndërmarrjeve dallon në mes të rajoneve. Kështu te aktiviteti “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit”, ndërmarrjet janë të përqendruara në rajonin e Prishtinës me 38.71%, pastaj Prizreni me 22.58%, i pasuar nga rajoni i Pejës me 16.13%, përderisa rajoni i Ferizajt, Gjilanit dhe Mitrovicës marrin pjesë me nga 6.45% dhe rajoni i Gjakovës me vetëm 3.23%.

Në aktivitetin “Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit”, për nga numri i ndërmarrjeve, prinë rajoni i Prizrenit me 35%, rajoni i Prishtinës me 20%, rajoni i Ferizajt dhe Pejës me nga 15%, rajoni i Gjilanit me 10%, rajoni i Mitrovicës me 5% deri sa në rajonin e Gjakovës në këtë aktivitet nuk është evidentuar asnjë ndërmarrje.

Numri i ndërmarrjeve në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t”, dukshëm prinë në rajonin e Prishtinës me 47.06%, i pasuar nga rajoni i Ferizajt


me 23.53%, i treti me radhë është rajoni i Prizrenit me 17.64% dhe rajoni i Gjilanit me 11.76% të ndërmarrjeve. Ky aktivitet nuk është i shtrirë në rajonin e Pejës, Mitrovicës dhe Gjakovës.

5.2 Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i letrës dhe produkteve prej letrës

Indikator tjetër i rëndësishëm për tu analizuar, është punësimi edhe pse krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese (sektorit C), ky nën sektor radhitet i katërmëdhjeti me radhë me 1.65% të punësuar.

Aktiviteti i cili prinë në punësim, në nën sektorin e letrës, është “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit”, me 40.23%, aktiviteti “Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit” me 32.33% dhe aktiviteti i tretë me radhë është “Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t” me 12.79%.

Figura 22. Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i letrës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Punësimi të nën sektori i letrës, prinë në rajonin e Prishtinës me 33.49%, Prizrenit me 31.40%, Ferizajt me 14.19%, rajonin e Pejës me 10.47%, Gjilanit me 6.98%, Gjakovës me 2.79% dhe në rajonin e Mitrovicës vetëm me 0.70%.

Në aktivitetin “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit”, punësimi është i përqendruar kryesisht në rajonin e Prishtinës me 60.12%, i pasuar nga rajoni i Pejës me 21.97%, Gjilanit me 8.67%, rajoni i Prizrenit 4.62%, Ferizajt 1.73%, Mitrovicës po ashtu me 1.73%, dhe rajoni i Gjakovës me 1.16%.


Përqendrimi i punësimit të aktiviteti “Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit”, është në rajonin e Prizrenit me 74.82%, pastaj me nga 8.63% radhitet rajoni i Ferizajt dhe Gjilanit, rajoni i Prishtinës me 5.04%, rajoni i Pejës dhe Mitrovicës me nën 4%, deri sa rajoni i Gjakovës nuk ka asnjë ndërmarrje, andaj as të punësuar, në këtë aktivitet.

Punësimi në aktivitetin “Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t”, në masë të konsiderueshme, është i përqendruar në rajonin e Ferizajt me 67.27%, pastaj radhitet rajoni i Prishtinës me 18.18%, rajoni i Prizrenit me 9.09%, rajoni i Gjilanit me 5.45%, ndërsa rajonet e Pejës, Mitrovicës dhe Gjakovës nuk kanë të punësuar në këtë aktivitet.

5.3 Eksporti sipas aktiviteteve të nën sektori i letrës dhe produkteve prej letrës

Eksporti të nën sektori i letrës dhe produkteve prej letrës, krahasuar me aktivitetet tjera të industrisë përpunuese, radhitet në vendin e pesëmbëdhjete me 0.94%, në total të sektorit C. Krahasimi i aktiviteteve në kuadër të këtij nën sektori, tregon se aktiviteti “Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit” dominon me 68.86%, pastaj radhitet aktiviteti “Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t” me 13.94%, ndërsa “Prodhimi i brumit të letrës dhe kartonit” me 8.72% etj.

Figura 23. Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i letrës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Eksporti i Kosovës, të nën sektori i letrës dhe produkteve prej letrës, është i përqendruar në vendet e CEFTA-së me 92.07%. Ky nën aktivitet eksporton në vendet e BE-së, 4.87%, vendet e EFTA-së 2.1%, deri sa në vendet tjera vetëm 1.05%.

Aktiviteti “Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit”, prinë në eksport në kuadër të nën sektorit të letrës dhe eksportin e ka të përqendruar në vendet e CEFTA-së me 93.02%, ku Shqipëria merr pjesë me 60.75% dhe Maqedonia e Veriut me 28.86%, deri sa në vendet e BE-së eksporti është vetëm 6%.

Në kuadër të nën sektorit të letrës dhe produkteve prej letrës, aktiviteti “Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t”, radhitet në vendin e dytë në eksport. Eksporti në vendet e CEFTA-së është 88.68%, në vendet e EFTA-së 5.5%, vendeve tjera 5.5%, deri sa në vendet e BE-së eksporton vetëm 0.07%.

Vendet ku më shumë eksportohen produktet e aktivitetit “Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t” janë: Bosnjë dhe Hercegovinë me 59.16%, Shqipëri me 12.99%, Maqedoninë e Veriut 8.41%, Zvicër 5.54%.


Prodhimi i brumit të letrës dhe kartonit, në eksport është i përqendruar në vendet e CEFTA-së me 93.86%, kryesisht në Maqedoninë e Veriut me 54.98%, Mal të Zi 21.78%, Shqipëri 11.65%, Serbi 5.44% etj. Analizat tregojnë se eksportet kryesisht me mbi 99.5% janë nga artikujt e letrës dhe kartonit dhe vetëm rreth 0.5% të brumit të letrës.

5.4 Importi sipas aktiviteteve të nën sektorit i letrës dhe produkteve prej letrës

Nën sektori i letrës, krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, radhitet e tetëmbëdhjeta me 1.87%, në importin e përgjithshëm të sektorit C.

Në import prinë aktiviteti “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit” me 39.24%, i pasuar nga “Prodhimi i brumit të letrës, letrës dhe kartonit” me 35.58%, “Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit” me 17.29%.

Figura 24. Importet sipas aktiviteteve të nën sektorit i letrës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Importet e nën sektorit të letrës, nga vendet e BE-së janë 42.40%, vendet e CEFTA-së me 37.81%, nga vendet tjera me 19.25% dhe nga vendet e EFTA-së me vetëm 0.54%.

Produktet e aktivitetit “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit”, importohen nga vendet e CEFTA-së me 42.97%, vendet e BE-së 40.46%, nga vendet tjera 15.44% dhe nga vendet e EFTA-së me 1.13%.

Importi i këtij aktiviteti kryesisht është nga Shqipëria me 23.85%, pastaj Serbia me 13.14%, vendi i tretë me radhë në import të këtij aktiviteti është Turqia me 12.84%, pastaj nga Polonia 10.37% etj.

Importi më i lartë, sa i përket produkteve të aktivitetit “Prodhimi i brumit të letrës, letrës dhe kartonit”, është nga vendet e BE-së me 52.12%, pastaj nga vendet e CEFTA-së me 24.39%, vendet tjera me 23.27% dhe vendet e EFTA-së me vetëm 0.22%.

Vendet nga të cilat importohen këto produktet të këtij aktivitetit janë: Serbia 19.14%, Italia 11.53%, Gjermania 10.28%, Turqia 8.38% etj.

Importi i produkteve të aktivitetit “Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhi prej letrës dhe kartonit” është nga vendet e CEFTA-së me 51.98%, vendet e BE-së 35.42%, vendet tjera 12.58% dhe nga vendet e EFTA-së vetëm 0.02%.

Importi më i lartë i produkteve të këtij aktiviteti, sipas vendeve është: nga Serbia 36.01%, Gjermania 15.20%, Maqedonia e Veriut 11.99%, Turqia 9.80%, Rumania 7.75% etj.

6. Prodhimi i Produkteve Kimike

Nën sektori i “Prodhimit i produkteve kimike”, në kuadër të industrisë përpunuese (Sektorit C), krahasuar me nën sektorët tjerë, në punësim radhitet në vendin e njëmbëdhjetë. Ky nën sektor, për nga numri i ndërmarrjeve si dhe në eksport radhitet në vendin e dhjetë, derisa në import radhitet në vendin e pestë.

Tabela 7. Nën sektori i prodhimit të produkteve kimike sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit

Kodi	SEKTORI C - Prodhimi i produkteve kimike	Numri i ndërmarrjeve	Numri i të punësuarve	Eksporti	Importi
2041	Prodhimi i sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim	28	117	571,795.84	30,678,036.67
2016	Prodhimi i plastikës në formë primare	25	196	311,160.32	60,887,098.63
2030	Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës	16	187	1,723,577.99	34,178,607.51
2052	Prodhimi i ngjitësve	6	11	128,279.37	3,652,413.81
2042	Prodhimin e parfumeve dhe preparateve të tualetit	5	6	2,196,832.00	38,683,291.64
2015	Prodhimi i plehrave kimike dhe komponimeve të azotit	4	4	119,476.86	13,627,903.97
2014	Përpunimi i produkteve të tjera kimike me bazë organike	4	23	69,929.06	7,922,530.79
2013	Prodhimi i produkteve të tjera kimike me bazë inorganike	3	47	20,349.70	2,655,992.74
2051	Prodhimi i eksplozivëve	3	8	-	1,682,876.82
2011	Prodhimi i gazrave industriale	3	14	-	1,184,842.42
2012	Prodhimi i ngjyrave dhe pigmenteve	2	8	45,956.35	2,558,711.92
2053	Prodhimi i vajrave esenciale	2	10	59,200.55	3,926,127.20
2020	Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike	1	8	294,871.58	3,496,322.12
2059	Prodhimi i produkteve të tjera kimike p.k.t.	1	0	214,785.45	16,656,526.61
2060	Prodhimi i fibrave sintetikë dhe artificiale	1	3	111,060.19	3,621,610.79
2017	Prodhimi i gomës sintetike në formë primare	0	0	-	1,230,002.81
	Totali	104	642	5,867,275.26	226,642,896.45


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Në kuadër të këtij nën sektori, për nga numri i ndërmarrjeve prinë aktiviteti “Prodhiimi i sapunit, detergjenteve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim”, deri sa në punësim, prinë aktiviteti “Prodhiimi i plastikës në formë primare, ne eksport prinë “Prodhiimin e parfumeve dhe preparateve të tualetit”, në import prinë aktiviteti “Prodhiimi i plastikes ne formë primare”.

6.1 Ndërmarrjet sipas aktiviteteve te nën sektori i produkteve kimike

Analizat e të dhënave për numrin e ndërmarrjeve në nën sektorin e produkteve kimike, tregojnë se për nga numri i ndërmarrjeve prinë aktivitetet e mjeteve higjienike, “Prodhiimi i sapunit, produkteve te pastrimit dhe preparateve për shkëlqim” me 26.92%, pastaj aktiviteti “Prodhiimi i plastikes në formë primare” me 24.04%, si dhe në vendin e tretë radhitet aktiviteti “Prodhiimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës” me 15.38%.

Figura 25. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve te nën sektori i produkteve kimike



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Shtirja rajonale e aktivitetit “Prodhiimi i sapunit, detergjenteve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim” sipas numrit të ndërmarrjeve është: Prishtina me 53.6%, Prizreni me 14.29%, pastaj Ferizaj, Gjlani, Mitrovica dhe Gjakova me nga 7.1% si dhe Peja me 3.6%.


Në aktivitetin “Prodhimi i plastikës në formë primare”, prinë rajoni i Gjilanit me 32%, Prishtina me 24 %, rajoni i Ferizajt me 20 %, Gjakova 12%, Prizreni 8%, Mitrovica 4%, kurse Peja nuk ka ndërmarrje në këtë aktivitet.

Numri më i madh i ndërmarrjeve të aktiviteti “Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës”, me numër më të madh të ndërmarrjeve është rajoni i Mitrovicës, me 25 %, Peja me 18.8%, Ferizaj 18.8%, Prizreni 18.8%, Prishtina 12.5%, Gjakova 6.3% dhe Gjilani nuk ka ndërmarrje në këtë aktivitet.

6.2 Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve kimike

Punësimi në aktivitetet e nën sektorit të produkteve kimike, është i përqendruar me së tepërmi te “Prodhimi i plastikës në formë primare” me 30.53%, pastaj kemi “Prodhimin i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës” me 29.13 % dhe aktiviteti i tretë me radhë që ndikon në punësim të nën sektori i produkteve kimike është “Prodhimi i sapunit, detergjenteve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim” me 18.22%.

Figura 26. Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve kimike



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përveç përqendrimit të numrit të punësuarve nëpër aktivitetet e nën sektorit të produkteve kimike, kemi analizuar edhe shtrirjen e këtyre aktiviteteve nëpër rajonet e Kosovës. Përderisa në aktivitetin “prodhimi i plastikës në formë primare” ishin të punësuar 30,53% punëtorë, analizat tregojnë se përfshirja më e madhe e këtyre të punësuarve është në rajonin e Gjilanit 69.4%, Ferizajt 14.3%, Gjakovës 4.6%, Prizrenit 3.1%, Prishtinës 0.9%, kurse Mitrovica dhe Peja nuk kanë të punësuar në këtë aktivitet.

Në kuadër të aktivitetit “Prodhimin i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës” përfshirja më e madhe e numrit të punësuarve është në rajonin e

Mitrovicës, me 36.4%, atë të Prizrenit me 26.2%, pastaj rajoni i Pejës me 21.9%, Prishtinës me 12.8%, Ferizajt me 1.6% dhe Gjakovës me 1.1%, përderisa në rajonin e Gjilanit dhe Pejës nuk ka të punësuar, në këtë aktivitet.


Përfshirja më e madhe e numrit të punësuarve, në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i sapunit, detergjenteve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim” është në rajonin e Prishtinës me 56.4%, pastaj është në rajonin e Prizrenit me 22.2 %, Mitrovicës me 6.8%, Gjakovës me 5.1%, Gjilanit me 4.3%, Ferizajt me 2.6% dhe në atë të Pejës me 2.6%.

6.3 Eksporti sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve kimike

Eksporti i nën sektorit të produkteve kimike, është një indikatorë tjetër që është analizuar në këtë raport, pas atij të punësimit dhe numrit të ndërmarrjeve, dhe krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese (Sektori C), radhitet në vendin e dhjetë.

Të dhënat për krahasimin e eksporteve të aktiviteteve brenda nën sektorit të produkteve kimike, tregojnë se me 37.34% prinë aktiviteti i “Prodhimi i parfumeve dhe preparateve të tualetit”, pastaj me 29.38% radhitet “Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës” me 9.75%, aktiviteti “Prodhimi i sapunit, detergjenteve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim” dhe “Prodhimi i plastikës në formë primare” me 5.3%.

Figura 27. Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve kimike



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përqendrimi më i madhe i eksporteve të Kosovës për prodhimet e produkteve kimike është në vendet e CEFTA-së 62.65%, pastaj ato të BE-së me 33.71%, vendet e EFTA-së me 2.71% dhe Vendet e tjera me vetëm 0.93%.

Kështu aktiviteti që përfshinë “Prodhimin e parfumeve dhe preparateve të tualetit”, eksporton në vendet e CEFTA-së, në vlerë prej 53.38% , në vendet e BE-së në vlerë prej 45.85% dhe 0.76 % në vendet e EFTA-së. Vendet në të cilat eksportohen më së tepërmi produktet e aktivitetit “Prodhimi i parfumeve dhe preparateve të tualetit” janë: në Shqipëri 24.88%, në Holandë 18.26%, në Maqedoni 16.41%, Itali 13.26%, etj.

Aktiviteti “Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës” eksportin e ka të përqendruar në vendet e CEFTA-së në vlerë prej 62.76%, vendet e BE-së 29.06%, EFTA-së 7.73% dhe në Vendet tjera 0.80%. Vendet në të cilat eksportohet më së tepërmi këto produkte janë: në Shqipëri 23.86%, në Gjermani 22.02%, në Mali të Zi 21.78%, në Maqedonia 14.31% etj.


Produktet e aktivitetit “Prodhimi i sapunit, detergjenteve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim”, eksportin më të madh e ka në vendet e CEFTA-së, në vlerë prej 90.2 % dhe në vendet e BE-së me 9.40%. Vendet në të cilat eksportohen më së tepërmi janë: Shqipëri me 39.05%, Maqedonia 30.73 %, Belgjika 9.31%, Mali i Zi 8.41% etj.

6.4 Importi sipas aktiviteteve të nën sektorit të produkteve kimike

Importi i nën sektorit të produkteve kimike, është një indikatorë tjetër që është analizuar në këtë raport, krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese (Sektori C) dhe radhitet në vendin e pestë.

Të dhënat për krahasimin e importeve të aktiviteteve brenda nën sektorit të produkteve kimike, tregojnë se me 26.86% prinë aktiviteti “Prodhimi i plastikës në formë primare”, pastaj me 17.07.% radhitet “Prodhimin e parfumeve dhe preparateve të tualetit”, me 15.08 %, aktiviteti “ Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës” dhe “Prodhimi i sapunit, detergjenteve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim”, me 13.54%.

Figura 28. Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve kimike



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përqendrimi më i madh i importeve të Kosovës për prodhimet e produkteve kimike në kuadër të aktiviteteve të këtij nën sektori, për vitin 2018 është nga vendet e BE-së, me 52.38% pastaj nga Vendet tjera, me 29% dhe nga vendet e CEFTA-së 18%.

Kështu aktiviteti që përfshinë “Prodhi mi i plastikës në formë primare” importin më të lartë e ka nga Vendet e tjera me 52%, pastaj nga vendet e BE -së me 20% , nga vendet e CEFTA-së në vlerë prej 6.44% dhe vetëm 13.8 % nga vendet e EFTA-së.

Vendet nga të cilat importohet më së tepërmi “Prodhi mi i plastikës në formë primare” janë: Kina me 19.53%, pastaj Irani me 14.78%, Gjermania me 11.54% etj.

Në aktivitetin “Prodhi min e parfumeve dhe preparateve të tualetit ” importi është i përqendruar në vendet e BE-së me 72.81%, pastaj në Vendet tjera 25.32%, si dhe në vendet e CEFTA-së me 5.44 % .

Aktiviteti “Prodhi mi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës” 61.05% të importit e ka nga vendet e BE-së, pastaj nga vendet e CEFTA-së 28.43% dhe Vendet tjera 10.43%.

7. Prodhimi i Produkteve të Gomës dhe të Plastikës

Nën sektori i prodhimit të produkteve të gomës dhe plastikës, në kuadër të dhjetë nën sektorëve krahasues në punësim të industrisë përpunuese, Sektori C, është në vendin e katërt. Ky nën sektor, për nga numri i ndërmarrjeve, është në vendin tretë, eksporti radhitet në vendin e dytë ndërsa importi radhitet në vendin e tetë.

Tabela 8. Nën sektori i prodhimit të gomës dhe plastikës sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit

Kodi	SEKTORI C - Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	Numri i ndërmarrjeve	Numri i të punësuarve	Eksporti	Importi
2223	Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari	352	1566	11,285,917.03	12,027,697.31
2229	Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës	81	309	3,637,326.30	21,668,407.19
2221	Prodhimi i pllakëzave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profileve	32	192	13,922,652.58	73,521,836.04
2222	Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim	31	276	12,140,878.57	16,372,440.42
2211	Prodhimi i gomave të jashtme dhe të brendshme të automjeteve; mvëshja dhe riparimi i gomave	5	29	16,323.14	16,772,045.94
2219	Prodhimi i gomave të jashtme dhe të brendshme të automjeteve; mvëshja dhe riparimi i gomave	3	3	5,451,054.69	10,746,505.26
	Total	504	2,375	46,454,152.31	151,108,932.16


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Në kuadër të këtij nën sektori, për nga numri i ndërmarrjeve prinë aktiviteti “Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari”, në punësim, prinë “Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari”, në eksport prinë “Prodhimi i pllakëzave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profileve” edhe në import prinë i njëjti aktivitet.

7.1 Ndërmarrjet sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës

Analizat e të dhënave për numrin e ndërmarrjeve në nën sektorin e produkteve të gomës dhe plastikës, për nga numri i ndërmarrjeve prinë aktiviteti “Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari” me 69.84 %, pastaj aktiviteti “Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës” me 16.07%, si dhe në vendin e tretë aktiviteti “Prodhimi i pllakëzave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profileve” me 6.35%.

Figura 29. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI


Në kuadër aktivitetit “Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari” numri më i madhe i ndërmarrjeve është në rajonin e Prishtinës, me 25.2%, pastaj në atë të Prizrenit me 19.3%, Gjilanit 14.2%, Ferizajt 13.4%, Pejës 9.9%, Gjakovës 9.7% dhe në rajonin e Mitrovicës me 8.2%.

Aktiviteti “Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës” prinë në rajonin e Prishtinës me 25.92%, në atë të Prizrenit me 23.45%, Ferizajt dhe Gjakovës me nga 13.6%, të Gjilanit me 8.6%, Pejës me 7.4% dhe Mitrovicë me 7.4%

7.2 Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës

Punësimi të aktivitetet e nën sektorit të produkteve të gomës dhe plastikës, është i përqendruar me së tepërmi të aktiviteti “Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari” me 65.94%, pastaj kemi “Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës” me 13.01 % dhe aktiviteti i tretë me radhë që ndikon në punësim të nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës është “Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim” me 11.62%.

Figura 30. Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përveç përqendrimit të punësuarve nëpër aktivitetet e nën sektorit të produkteve të gomës dhe plastikës, kemi analizuar edhe shtrirjen e këtyre aktiviteteve nëpër rajonet e Kosovës. Përderisa në aktivitetin “Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari” ishin të punësuar 65,92% punëtorë, analizat tregojnë se përfshirja më e madhe e këtyre të punësuarve është në rajonin e Prishtinës me 24.7%, Prizrenit me 22.5%, Gjilanit me 17.2, Ferizajt me 9.9%, Pejës me 9.2%, Gjakovës me 8.4% dhe në atë të Mitrovicës me 8.1%

Në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës” ishin të punësuar 13.01%. Përfshirja më e madhe e numrit të punësuarve është në rajonin e Prishtinës me 40.5%, pastaj në atë të Prizrenit me 21.4%, Gjakovës me 11.7%, Ferizajt me 11.3%, Pejës me 6.1%, Gjilanit me 4.9% dhe Mitrovicës me 4.2%.


Në kuadër të aktivitetit të tretë me radhë “Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim” janë të punësuar 11.62%. Në këtë përqindje të punësuarve, rajoni i Ferizajt merr pjesë me 39.5%, Prizreni me 22.1 %, Mitrovica me 18.5%, Prishtinë me 9.1 %, Gjakova me 8.7%, Gjilani me 2.2%, përderisa në Pejë nuk është i zhvilluar ky aktivitet.

7.3 Eksporti sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës

Eksporti i nën sektorit të produkteve të produkteve të gomës dhe plastikës, është një indikatorë tjetër që është analizuar në këtë raport, pas atij të punësimit dhe numrit të ndërmarrjeve dhe krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, Sektori C, radhitet në vendin e dytë.

Të dhënat për krahasimin e eksporteve të aktiviteteve brenda nën sektorit të produkteve të gomës dhe plastikës, tregojnë se me 29.97% prinë aktiviteti “Prodhimi i pllakëzave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profileve”, pastaj me 26.14% radhitet “Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim” dhe me 24.29%, aktiviteti “Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari”.

Figura 31. Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përqendrimi më i madh i eksporteve të Kosovës për prodhimet e produkteve të gomës dhe plastikës është në vendet e BE-së me 45.37%, në ato të CEFTA-së me 15.33%, në vendet e EFTA-së me 5.45 % dhe në Vendet tjera me 4.59%.

Kështu aktiviteti që përfshinë “Prodhimi i pllakëzave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profileve”, eksporton në vendet e CEFTA -së 71.13% të produkteve, në vendet e BE-së në vlerë prej 12.8.% dhe 4.8 % në vendet e EFTA-së. Vendet në të cilat eksportohet më së tepërmi nga ky aktivitet janë: në Shqipëri 27.81.%, në Maqedoni 25.84%, në Serbi 16.36%, në Bullgari 6.56%, etj.

Aktiviteti “Prodhimi i plastikës për paketim” eksportin e ka të përqendruar në vendet e BE-së me 86.13% dhe në vendet e CEFTA-së me 13.69.%. Vendet në të cilat eksportohen më së tepërmi “Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim” janë: Holanda me 76.13%, Serbia me 8.77%, Belgjika me 7.66%, Shqipëria me 3.01% etj.


Produktet që përfshihen në aktivitetin “Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari”, eksportohen në vendet e BE-së me vlerë prej 44.88%, në vendet e EFTA-së 43.81.%, në vendet e CEFTA-së 6.28% dhe në Vendet tjera me 5.03%. Vendet në të cilat eksportohen më së tepërmi “Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari janë: në Zvicër 42.76%, në Kazakistan 34.53%, në Shqipëri 3.93%, në Maqedoni 1.19% etj.

7.4 Importi sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve të gomës dhe plastikës

Importi i nën sektorit të produkteve të gomës dhe plastikës, është një indikatorë tjetër që është analizuar në këtë raport, krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, Sektori C, radhitet në vendin e tetë.

Të dhënat për krahasimin e importeve të aktiviteteve brenda nën sektorit të produkteve të gomës dhe plastikes, tregojnë se me 48.65% prinë aktiviteti i “Prodhimi i pllakëzave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profileve”, pastaj me 14.34% radhitet “Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës”, me 11.10 %, aktiviteti “ Prodhimi i gomave të jashtme dhe të brendshme të automjeteve; m’veshja dhe riparimi i gomave” dhe “Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim” me 10.83%.

Figura 32. Importi sipas aktiviteteve të nën sektorit të produkteve gomës dhe plastikës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI-së

Përqendrimi më i madhe i importeve të Kosovës për prodhimet e produkteve të gomës dhe plastikes në kuadër të aktiviteteve të këtij nën sektori, për vitin 2018 është nga vendet e BE-së, me 48.48% pastaj nga Vendet tjera, me 28.13% dhe me vendet e CEFTA-së 22.43%.

Aktiviteti që përfshinë “Prodhimi i pllakëzave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profileve” është në vendin e parë për importe. Importi nga vendet e BE -së është 59.08 % , nga vendet e CEFTA-së në vlerë prej 24.50% ,Vendet tjera 15.58% dhe vendet e EFTA-së 0.84%.

Vendet nga të cilat importohet më së tepërmi “Prodhimi i pllakëzave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profileve” janë: Gjermania me 33.36%, Maqedonia 11.52%,Turqia 11.48% dhe Serbia 10.80% .

Importi nga aktivitetit “Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës” është: nga Vendet tjera 54.94%,pastaj nga vendet e BE-së 27.57% si dhe nga vendet e CEFTA-së 14.32 %.

Vendet nga të cilat importohet më së tepërmi “Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës” janë: nga Kina 29.57%, nga Turqia 27.29%, nga Italia 9.10%, nga Serbia 9% dhe nga Gjermania 6.33%.

Importi i produkteve nga aktiviteti “Prodhimi i gomave të jashtme dhe të brendshme të automjeteve; m’veshja dhe riparimi i gomave” është i përqendruar nga vendet e BE-së me 40.06%, pastaj nga Vendet tjera me 53.79% si dhe nga vendet e CEFTA-së me 6 % .

Vendet nga të cilat importohet më së tepërmi “Prodhimi i gomave të jashtme dhe të brendshme të automjeteve; m’veshja dhe riparimi i gomave” janë: nga Kina 41.06%, nga Gjermania 9.6%, nga Polonia 8.7%, nga Turqia 17.13%, nga Serbia 6.08% etj.

8. Prodhimi i Metaleve

Nën sektori i prodhimit të metaleve, në kuadër të Sektorit C, (Industria Përpunuese), për nga numri i ndërmarrjeve radhitet në vendin e njëmbëdhjetë, ndërsa për nga numri i të punësuarve radhitet në vendin e tetë, kurse në eksport ky nën sektor radhitet në vendin e parë, në kuadër të Sektorit C, po ashtu edhe në import në totalin e sektorit C, e zënë vendin e tretë.

Tabela 9. Nën sektori i metaleve sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit

Kodi	SEKTORI C - Prodhimi i Metaleve	Numri i ndërmarrjeve	Numri I të punësuarve	Eksporti	Importi
24.1	Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë, si dhe i ferro legurave	22	867	36,945,115.30	206,344,411.50
24.2	Prodhimi i tubave, gypave, profileve bosh dhe pajisjeve të tjera nga çeliku	4	18	22,663,168.17	9,457,833.00
24.33	Formimi ose palosja e ftohtë	1	13	208,814.44	11,048,187.10
24.34	Tërheqja e ftohtë e telit, shufrave dhe mbështjellja e rripave të ngushtë	9	12	893,109.20	5,614,296.38
24.41	Prodhimi i metaleve të çmuara	22	28	-	5,329.75
24.43	Prodhimi i plumbit, aluminit, zinkut dhe kallajit	24	64	2,336,795.48	21,377,245.88
24.44	Prodhimi i bakrit	1	4	34,491.55	8,619,172.42
24.51	Derdhja (fonderia) e hekurit	4	6	54,063.05	820,338.08
24.52	Derdhja (fonderia) e çelikut	3	9	-	259,200.36
24.53	Derdhja (fonderia) e metaleve të lehta	8	30	-	-
24.54	Derdhja (fonderia) dhe prodhimi i metaleve të tjera jo-ferrike	1	-	440	308259.16
Totali		99	1051	63,135,997.19	263,854,273.63

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI


Në kuadër të këtij nën sektori, për nga numri i ndërmarrjeve prinë aktiviteti “Prodhimi i plumbit, aluminit, zinkut dhe kallajit”, deri sa në punësim, në eksport dhe import prinë “Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë, si dhe i ferro legurave”.

Aktiviteti i “Prodhimi i tubave, gypave, profileve bosh dhe pajisjeve të tjera nga çeliku”, ka raport më të mirë në eksport, ku merr pjesë me 70.55% krahasuar me importin, i cili është në vlerë 29.45%.

8.1 Ndërmarrjet sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të metaleve

Analizat e të dhënave për numrin e ndërmarrjeve në nën sektorin e metaleve, tregojnë se për nga numri i ndërmarrjeve në vendin e parë radhitet aktiviteti “Prodhimi i plumbit, aluminit, zinkut, dhe kallajit me 24.24%”, i pasuar nga dy aktivitete me përqindje të njëjtë “prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë dhe i ferro legurave” dhe “prodhimi i metaleve të çmuara” me nga 22.22 %, përderisa aktiviteti “Tërheqja e ftohtë e telit, shufrave, dhe mbështjella, e rripave të ngushtë” radhitet në vendin e katërt , me 9.09%.

Figura 33. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektori i metaleve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Sa i përket shtrirjes së këtyre ndërmarrjeve, të dhënat tregojnë se numri më i madhe i ndërmarrjeve, në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i plumbit, aluminit, zinkut, dhe kallajit”, shtrihet në rajonin e Prishtinës, me 50%, pastaj në atë të Mitrovicës me 20.83%, në tri rajonet tjera si: Prizreni, Peja dhe Gjakova me nga 8.33%, të ndërmarrje aktive, ndërsa në rajonin e Gjilanit nuk ka shtrirje ky aktivitet. Aktiviteti “Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë si dhe i ferro legurave” ka një shtrirje të ndërmarrjeve në rajonin e Prishtinës me 39.13%, pasuar nga rajoni


i Gjakovës me 26.08%, pastaj ai i Ferizajt me 13.04% ndërmarrje, rajoni i Pejës dhe Mitrovicës me nga 8.69%, përderisa rajoni i Prizrenit nuk ka ndërmarrje të evidentuara në këtë aktivitet. Në vendin e tretë të këtij nën sektori, me numër të ndërmarrjeve, radhitet aktiviteti “Prodhimi i metaleve të çmuara”. Ndërmarrjet e këtij aktiviteti shtrihen në rajonin e Ferizajt me 36.36%, pasuar nga Prizreni me 31.81%, e më pas nga regjioni i Prishtinës me 22.72%, nga numri i ndërmarrjeve në këtë aktivitet. Regjioni i Gjilanit nuk ka ndërmarrje aktive në këtë aktivitet të trajtuar.

Bazuar në të dhënat e analizuara, numri më i madh i ndërmarrjeve, krahasuar me totalin e përgjithshëm të ndërmarrjeve, shtrihet në rajonin e Prishtinës me 33.33%, pasuar nga rajoni i Prizrenit me 16.16% të ndërmarrjeve dhe në vendin e tretë rajoni i Ferizajt dhe Gjakovës me nga 14.14% përderisa numrin më të vogël të ndërmarrjeve në këtë nën sektor e kemi në rajonin e Pejës me 6.06%.

8.2 Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të metaleve

Në aktivitetet e nën sektorit të metaleve, punësimi është i përqendruar më së tepërmi te “Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë si dhe ferro legurave” me 82.49%, të punësuar, i pasuar nga aktiviteti “Prodhimi i plumbit, aluminit, zinkut dhe kallajit” me 6.09 %, të punësuar, dhe në vendin e tretë radhitet aktiviteti “Derdhja (fonderia) e metaleve të lehta”, me vetëm 2.85% të punësuar.

Figura 34. Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i metaleve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përveç përqendrimit të punësuarve për aktivitetet e nën sektorit të metaleve kemi analizuar edhe shtrirjen e këtyre aktiviteteve nëpër rajonet e Kosovës. Përderisa në aktivitetin “Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë si dhe ferro legurave” ishin të punësuar 82.49%, punëtorë, analizat tregojnë se shpërndarja më e madhe e këtyre të punësuarve është në rajonin e Prishtinës me


95.15%, pasuar nga rajoni i Pejës me 1.38% të punësuarve, ndërsa rajoni i Mitrovicës dhe Gjakovës me nga 1.03% të punësuar, Gjlani me 0.80%, dhe Ferizaj me 0.46% të punësuar. Të dhënat tregojnë se rajoni i Prizrenit nuk ka punëtor të angazhuar në këtë aktivitet.

Në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i plumbit, zinkut, dhe kallajit” përfshirja më e madhe e numrit të punësuarve është në rajonin e Prishtinës, me 54.68% të punëtorëve, pasuar nga rajoni i Ferizajt me 15.62%, po ashtu një shpërndarje të përafërt e kemi edhe në rajonin e Pejës dhe atë të Mitrovicës me nga 14.06% dhe Prizreni me 1.56%. Rajoni i Gjilanit dhe ai i Gjakovës nuk kanë punëtorë të angazhuar në këtë aktivitet. Në kuadër të analizës mbi numrin më të lartë të punësimit krahasuar me rajonet, në vendin e parë me punësim radhitet rajoni i Prishtinës me 84.49%, pasuar nga rajoni i Prizrenit me 4.95 dhe në vendin e tretë radhitet rajoni i Pejës me 2.47%, pastaj ai i Ferizajt me 2.28%, Gjakova me 2.18%. Punësim më të vogël kemi në rajonin e Gjilanit dhe Mitrovicës me vetëm nga 1.81% të të punësuarve në këtë nën sektor.

8.3 Eksporti sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të metaleve

Eksporti i nën sektorit të produkteve të metaleve, është një indikatorë tjetër që është analizuar në këtë raport pas atij të punësimit dhe numrit të ndërmarrjeve dhe krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, Sektori (C), ky nën sektor radhitet në vendin e parë me eksport. Të dhënat për krahasimin e eksporteve të aktiviteteve brenda nën sektorit të metaleve, tregojnë se me 58.52% prinë aktiviteti “Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë, si dhe i fërro legurave”, pastaj me 35.90% radhitet “Prodhimi i tubave, gypave, profileve bosh dhe pajisjeve tjera”, pasuar nga aktiviteti “Prodhimi i plumbit, aluminit, zinkut, dhe kallaji” 3.70%, të eksportit të produkteve. Aktivitetet tjera kanë vlerë më të ulët të eksportit.

Figura 35. Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i metaleve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përqendrimi më i madh i eksporteve të Kosovës për prodhimet e produkteve në kuadër të aktiviteteve të këtij nën sektori është në Vendet e tjera, 97.45% duke e pas parasysh Indin, pastaj ato të CEFTA-së, me 1.71% dhe më pak eksportohen në vendet e BE-së, me 0.71%, në totalin e eksporteve nga ky aktivitet.

Vendet në të cilat eksportohen më së tepërmi “Prodhimi i hekurit, çelikut bazë dhe fërro legurave” janë: në Indi me vlerë prej 97.45%, në Belgjikë me 80.66% të eksportit të produkteve, në Shqipëri me 45.16% dhe në Maqedoninë e Veriut në vlerë prej 42.12%.


Aktiviteti “Prodhimi i tubave, gypave, profileve bosh, dhe pajisjeve tjera”, eksportin e ka të përqendruar në vendet e CEFTA-së me vlerë prej 97.43%, kryesisht në Serbi 27.65% pastaj në vendet e EFTA-së me 2.17%, dhe atë në Zvicër me 85.84% si dhe në vendet e BE-së me 0.40%, kryesisht në Holandë me 90.99% të eksportit nga vendet e BE-së.

Produktet e aktivitetit “Prodhimi i plumbit, zinkut, aluminit, dhe kallajit”, të eksportohen në vendet e CEFTA-së në vlerë 35.92%, kryesisht në Serbi me vlerë prej 30.02 %, pastaj në Shqipëri me 3.23%, Maqedoni të Veriut me 1.61%. Vendet e BE-së radhiten në vendin e dytë, sa i përket eksporteve të këtyre produkteve, pra Bullgaria në vlerë prej 27.33% dhe në vendet e EFTA-së, Zvicra me vlerë prej 4.75% dhe në Vendet tjera, kryesisht me Turqi në vlerë prej 0.66% të eksportit.

8.4 Importi sipas aktiviteteve të nën sektori i prodhimit të metaleve

Importi i produkteve të metaleve krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese - Sektori C, radhitet në vendin e parë sa i përket importit. Nëse krahasojmë importin e aktiviteteve brenda nën sektorit të metaleve me 78.20% prinë aktiviteti i “Prodhimi i hekurit, çelikut, bazë si dhe fërro legurave”, pastaj radhitet “Prodhimi i plumbit, zinkut, aluminit dhe kallajit” me 8.10 %, i pasuar nga aktiviteti “Formimi ose palosja në të ftoftë me 4.19%, aktivitet tjera kanë vlera të importit me solide.

Figura 36. Importet sipas aktiviteteve të nën sektori i metaleve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përqendrimi më i madh i importeve të Kosovës për prodhimet e produkteve në kuadër të aktivitetit “Prodhim i hekurit, çelikut, bazë si dhe ferro legurave” në kuadër të këtij nën sektori është nga vendet e CEFTA-së, me 76.97%, pastaj nga Vendet e tjera me 15.95%, pasuar nga vendet e BE-së me 7.05% dhe në përqindje të vogël nga vendet e EFTA-së me 0.01%.

Kështu që aktiviteti “Prodhim i hekurit, çelikut, bazë si dhe ferro legurave”, importohet nga vendet e CEFTA-së, konkretisht Shqipëria me 57.50%, pasuar nga Bosnja dhe Hercegovina me 17.49%, dhe nga Maqedonia e Veriut me 15.05%, si dhe nga Serbia me 9.95%.

Nga vendet tjera import më të lartë në këtë aktivitet kemi: nga Ukraina me 41.35%, pasuar nga Rusia me 40.60% dhe nga Kina me 9.59%.

Importi i aktivitetit “Prodhim i plumbit, zinkut, aluminit dhe kallajit”, prezantohet me 44.62% të importit me Vendet e tjera, kryesisht nga Turqia me 57.82% dhe nga Kina me 22.54%, India me 12.50%, pasuar nga vendet e CEFTA-së me 34.65%, konkretisht nga Shqipëria me 87.84%, pastaj nga vendet e BE-së, me 19.72%, konkretisht Gjermania me 24.81% dhe nga vendet e EFTA-së 0.99%, konkretisht nga Zvicra me 0.99%.

Aktiviteti “Formimi ose palosja e ftohtë” në import, prinë nga vendet e BE-së me 58.60%, kryesisht nga Greqia 60.61%, pastaj radhiten vendet e CEFTA-së me 32.98%, konkretisht Maqedonia e Veriut me 40.09%, pastaj nga Vendet tjera me 6.76%, konkretisht Turqia me 95.93%, nga ky import dhe vendet e EFTA-së me 1.65%, konkretisht Zvicra me totalin e importeve nga ky aktivitet. Edhe pse nën sektori i Prodhimit të Metaleve ka pas eksportin më të lartë në vitin 2018, prapë mbetet shqetësim vlera e lartë e importeve në këtë nën sektor.

9. Prodhimi i Produkteve të Fabrikua Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve

Nën sektori i prodhimit të produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve, është një nga nën sektorët më me potencial në vend. Në kuadër të sektorit C, ky nën sektor zë vendin e dytë për nga numri i ndërmarrjeve, ndërsa në punësim zë vendin e tretë, fokusi i këtij nën sektori është eksporti dhe renditet e pesta ndërsa në import zë vendin e njëmbëdhjetë.

Tabela 10. Nën sektori i prodhimeve të fabrikua metalike përveç makinerisë dhe pajisjeve sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit

Kodi	SEKTORI C - Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike përveç makinerisë dhe pajisjeve	Numri i ndërmarrjeve	Numri i të punësuarve	Eksporti	Importi
2511	Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre	208	1,435	3,942,042.29	19,084,325.68
2512	Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metalit	121	298	6,010,190.67	2,925,437.71
2521	Prodhimi i radiatorëve dhe kazanëve për ngrohje qendrore	7	16	2,914,896.10	7,616,085.47
2529	Prodhimi i tankerëve, rezervuarëve dhe kontejnerëve të tjerë prej metalit	4	3.00	83,557.39	1,320,123.05
2540	Prodhimi i armëve dhe municionit	0	0	0	2,601,674.24
2550	Farkimi, presimi, stampimi dhe palosja rrethore e metaleve; pluhuri metalurgjik	59	181	0	0
2561	Trajtimi dhe veshja e metaleve	41	81	0	0
2562	Përpunimi mekanik	69	175	0	0
2571	Prodhimi i thikave	2	3	8,967.07	3,953,026.08
2572	Prodhimi i bravave dhe cilindrave	2	2	402,118.41	16,133,100.15
2573	Prodhimi i veglave	3	2	392,006.89	7,392,543.31
2591	Prodhimi i kovave të çelikut dhe mbajtësve të tjerë të ngjashëm	1	3	55,567.66	748,069.67
2592	Prodhimi i ambalazheve prej metalit të lehtë	2	5	1,802.00	9,398,198.87
2593	Prodhimi i produkteve prej teli, zinxhiri dhe suste	16	71	2,501,321.25	9,006,153.56
2594	Prodhimi i vidave dhe kaçavidave	4	9	1,165,995.21	5,317,673.28
2599	Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t.	61	187	3,999,917	24,536,574
Totali		600	2,471	21,478,381.68	110,032,985.05

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Në kuadër të këtij nën sektori, sa i përket numrit të ndërmarrjeve dhe punësimit dominon aktiviteti “Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre”, ndërsa aktiviteti

“Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metalit”, ka eksportin me të madh, përderisa në import prin “Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre”.

Aktiviteti i “Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metalit”, ka raport më të mirë në eksport krahasuar me importin. Në këtë aktivitet eksporti në raport me vlerën e përgjithshme të eksportit merr pjesë me 27,98 % deri sa importi merr pjesë me 2.66%.

9.1 Ndërmarrjet sipas aktivitetit të nën sektori i prodhimeve të Fabrikua Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve

Analizat e të dhënave për numrin e ndërmarrjeve në nën sektorin e prodhimit të produkteve të fabrikua metalike përveç makinerisë dhe pajisjeve, tregojnë se për nga numri i ndërmarrjeve në vendin e parë radhitet aktiviteti “Prodhimi i Konstruksioneve metalike dhe pajisjeve të tyre” me 34.67%, i pasuar nga “Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metalit” me 20.17%, ndërsa në vendin e tretë radhitet “Përpunimi mekanik” me 11.50%.

Figura 37. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve të fabrikua metalike

PËRQINDJA E NDËRMARRJEVE SIPAS AKTIVITETEVE TË NËNSEKTORIT TË PRODHIMI I PRODUKTEVE TË FABRIKUARA METALIKE



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Sa i përket shtrirjes së këtyre ndërmarrjeve, të dhënat tregojnë se numri më i madhe i ndërmarrjeve, në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre”, shtrihet në rajonin e Prishtinës, me 26 %, pastaj në rajonin e Pejës, me 18% dhe shtrirja e njëjtë e ndërmarrjeve është në rajonin e Prizrenit dhe Ferizajt me nga 15%, pastaj Gjilani me 12%, Gjakova me 8% dhe Mitrovica me 5%.

Të dhënat tregojnë se aktiviteti “Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metalit” radhitet e dyta dhe ka shtrirjen më të madhe në rajonin e Prishtinës, me 21%, pastaj në atë të Gjilanit me 20%


dhe në rajonin e Pejës me 14%, ndonëse në rajonet tjera ka një përfshirje më të vogël, në Ferizaj me 13%, Gjakova me 12%, Prizreni dhe Mitrovica me nga 10%.

Aktiviteti “Përpunimi mekanik”, për nga numri i ndërmarrjeve radhitet në vendin e tretë dhe ka një shtrirje më të madhe në rajonin e Prizrenit, me 30%, pastaj e kemi rajonin e Prishtinës, me 28%, atë të Ferizajt me 13%, Gjakovës me 10%, rajonin e Pejës dhe Mitrovicës me nga 7% dhe rajonin e Gjilanit me 4%.

9.2 Punësimi sipas aktivitetit të nën sektori i prodhimeve të Fabrikua Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve

Në aktivitetet e nën sektorit të prodhimit të produkteve të fabrikua metalike përveç makinerisë dhe pajisjeve, punësimi është i përqendruar më së tepërmi të “Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pajisjeve të tyre” me 58.07%, pastaj kemi një përfshirje të punësuarve të aktiviteti “Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metalit”, me 12.06% dhe një numër prej 7.57% të punësuar, e kemi të aktiviteti që ka të bëjë me “Prodhimin e produkteve të tjera metalike p.k.t”.

Figura 38. Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve të fabrikua metalike përveç makinerisë dhe pajisjeve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përveç përqendrimit të punësuarve nëpër aktivitetet e nën sektorit të prodhimit të produkteve të fabrikua metalike përveç makinerisë dhe pajisjeve, kemi analizuar edhe shtrirjen e këtyre aktiviteteve nëpër rajonet e Kosovës. Analizat tregojnë se në aktivitetin “Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pajisjeve të tyre” ka një numër të punësuarve prej 58.7%, ku përfshirja më e madhe e këtyre të punësuarve është në rajonin e Ferizajt me 41%, në atë të Prizrenit dhe Prishtinës me nga 16%, Pejës me 12%, Gjakovës me 9%, Gjilanit me 4% dhe në rajonin e Mitrovicës me 2%.

Në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metalit” përfshirja më e madhe e numrit të punësuarve është në rajonin e Prishtinës, me 28%, në atë të Pejës me 20% dhe në rajonin e Gjiçanit me 17%. Në rajonin e Prizrenit, Ferizajt dhe Gjakovës është një shtrirje përafërsisht e njëjtë me nga 10% dhe në atë të Mitrovicës me 6%

Përfshirja më e madhe e numrit të punësuarve, në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t” është në rajonin e Prishtinës me 27%, pastaj atë të Gjiçanit me 25%, Ferizajt me 17%, Gjakovës me 11% të punësuar, ndërsa në rajonin e Prizrenit me 8% dhe një shifër e përafërt edhe në atë të Pejës me 7%, dhe një numër më i vogël i të punësuarve është në rajonin e Mitrovicës me 4%.

9.3 Eksporti sipas aktivitetit të nën sektori i prodhimeve të Fabrikuar Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve

Eksporti i nën sektorit të prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike përveç makinerisë dhe pajisjeve, është një indikator tjetër që është analizuar në këtë raport pas atij të punësimit dhe numrit të ndërmarrjeve, duke krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, ky nën sektor për nga eksporti radhitet në vendin e pestë.

Të dhënat për krahasimin e eksporteve të aktiviteteve brenda nën sektorit të produkteve të fabrikuar metalike përveç makinerisë dhe pajisjeve, tregojnë se me 27.98% prinë aktiviteti i “Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metalit”, pastaj me 18.62% radhitet “Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t” dhe me 18.35%, aktiviteti “Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pajisjeve të tyre”.

Figura 39. Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i produkteve të fabrikuar metalike përveç makinerisë dhe pajisjeve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përqendrimi më i madhe i eksporteve të Kosovës për prodhimet e produkteve në kuadër të aktiviteteve të këtij nën sektori është në vendet e EFTA-së, duke e pas parasysh Zvicrën, pastaj ato të BE-së dhe shumë më pak eksportohen në vendet e CEFTA-së, dhe në Vendet tjera.

Aktiviteti “Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metalit”, eksporton në vendet e EFTA-së në vlerë prej 61.5 %, në vendet e BE-së në vlerë prej 10.8% dhe vetëm 3.18% në vendet e CEFTA-së. Vendet në të cilat eksportohet më së tepërmi nga ky aktivitet janë: në Zvicër me vlerë prej 61.31%, në Gjermani me 7.47%, Francë në vlerë prej 1.86%, etj.

Aktiviteti “Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t”, eksportin e ka të përqendruar në vendet e BE-së me vlerë prej 33.50%, kryesisht në Holandë me 41.73%, pastaj në vendet e EFTA-së, në Zvicër me 17.77% dhe vendet e CEFTA-së, në Shqipëri me 4.62% etj.

Sa i përket aktivitetit “Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre” 37.48% të eksportit e ka në vendet e CEFTA-së, kryesisht në Shqipëri me 28.23% dhe në Maqedoni me 21.30%, pastaj në vendet e EFTA-së, siç është Zvicra me 17.83% etj.

9.4 Importi sipas aktivitetit të nën sektori i prodhimeve të Fabrikua Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve

Importi i produkteve të prodhimit të produkteve të fabrikua metalike përveç makinerisë dhe pajisjeve, krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, radhitet në vendin e njëmbëdhjetë.

Nëse krahasojmë importin e aktiviteteve brenda këtij nën sektori me 22.30% prinë aktiviteti i “Prodhimit të produkteve tjera metalike p.k.t”, pastaj radhitet “Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre” me 17.34 %, dhe “Prodhimi i bravave dhe cilindrave” me 14.66%.

	Prodhi mi i produkteve të tjera metalike p.k.t.	Prodhi mi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre	Prodhi mi i bravave dhe cilindrave	Prodhi mi i ambalazheve prej metalit të lehtë	Prodhi mi i produkteve prej teli, zinxhiri dhe suste	Prodhi mi i radiatorëve dhe kazanëve për ngrohje qendrore	Prodhi mi i veglave	Prodhi mi i vidave dhe kaçavidave	Prodhi mi i thikave	Prodhi mi i detyrës dhe dritareve prej metalit	Prodhi mi i armëve dhe municionit	Prodhi mi i tankerëve, rezervuarëve dhe kontejnerëve të tjerë prej metalit	Prodhi mi i kovave të çelikut dhe mbajtësve të tjerë të ngjashëm	Farkimi , presimi , stampi dhe palosja rrethor e metaleve; pluhuri metal...	Trajtimi dhe veshja e metaleve	Përpunimi mekanik
%	22.30	17.34	14.66	8.54	8.18	6.92	6.72	4.83	3.59	2.66	2.36	1.20	0.68	0.00	0.00	0.00

Përqendrimi më i madh i importeve të produkteve në Kosovë, në kuadër të aktiviteteve të këtij nën sektori është nga vendet e BE-së, pastaj nga ato me vendet tjera, dhe më pak import nga vendet e CEFTA-së dhe EFTA-së.

Vendet nga të cilat Importohen më së tepërmi produktet e aktivitetit “Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t” janë: nga Turqia me vlerë prej 28.6%, nga Kina 22.3%, nga Gjermania 11.3% etj.

Aktiviteti “Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre”, Importin e ka të përqendruar në vendet e BE-së me vlerë prej 22.5%, kryesisht nga Italia 22.2% si dhe nga vendet e CEFTA-së, pra nga Serbia me 9.6% dhe nga Shqipëri 9%.

Aktiviteti “Prodhimi i bravave dhe cilindrave”, vlerën prej 8.9% të Importit e ka nga vendet e BE-së, kryesisht nga Gjermania me 24.2 %, pastaj nga Kina me 18.1% dhe nga Austria me 17.4% etj.

10.Prodhimi i Mobileve

Nën sektori i prodhimit të mobileve, në kuadër të nën sektorëve të industrisë përpunuese (sektorit C), në punësim radhitet në vendin e pestë me 8.87%. Ky nën sektor për nga numri i ndërmarrjeve dhe eksportit radhitet në vendin e gjashtë, derisa në import, radhitet në vendin e nëntëmbëdhjetë krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese -Sektori C.

Tabela 11. Nën sektori i prodhimit të mobileve sipas, numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksportit dhe importit

Kodi	SEKTORI C - Prodhimi i mobileve	Numri i ndërmarrjeve	Numri i të punësuarve	Eksporti	Importi
310 & 3101	Prodhimi i mobilie dhe prodhimi i mobileve të zyrave dhe dyqaneve	72	305	1,767,674.25	22,819,866.63
3102	Prodhimi i mobilie të kuzhinës	166	582	2,578,071.89	860,199.63
3103	Prodhimi i dyshekëve	15	418	848,175.87	2,507,772.95
3109	Prodhimi i mobilie të tjera	153	1,009	5,347,909.76	23,451,096.92
Totali		406	2,314	10,541,832	49,638,936

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Në kuadër të këtij nën sektori, për nga numri i ndërmarrjeve, prinë aktiviteti “prodhimi i mobileve të kuzhinës”, deri sa në punësim, në eksport dhe import prinë “prodhimi i mobileve të tjera”.


Aktiviteti i prodhimeve të kuzhinës, ka raport më të mirë në eksport krahasuar me importin. Në këtë aktivitet eksporti në raport me vlerën e përgjithshme të eksport-importit të këtij aktiviteti, merr pjesë me 74.98%, deri sa importi merr pjesë me 25.02%.

Raporti mes eksportit dhe importit, edhe pse me import të lartë, krahasuar me aktivitetet tjera qëndron mirë edhe te aktiviteti i prodhimit të dyshekëve, ku nga vlera e përgjithshme e eksport – importit, të këtij aktiviteti, eksporti merr pjesë me 25.27% krahasuar me importin i cili merr pjesë me 74.73%.

10.1 Ndërmarrjet sipas aktiviteteve të nën sektori i mobileve

Analiza e të dhënave për numrin e ndërmarrjeve, në nën sektorin e mobileve, tregon se për nga numri i ndërmarrjeve, në vendin e parë radhitet aktiviteti “Prodhimi i mobileve të kuzhinës” me 40.89%, i pasuar nga “prodhimi i mobileve tjera” me 37.68%. Aktiviteti “Prodhimi i mobileve të përgjithshme (dhoma dite, fjetje dhe pritje) dhe mobileve të zyrave dhe dyqaneve” radhitet në vendin e tretë, me 17.73%.

Figura 41. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve të nën sektori i mobileve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Numri më i madh i ndërmarrjeve, në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i mobileve të kuzhinës”, është në rajonin e Ferizajt, me 43.98%, pastaj në rajonin e Prishtinës, me 19.88%, i treti me radhë është rajoni i Gjilanit me 11.45%, pastaj vjen rajoni i Pejës me 9.64%, rajoni i Prizrenit me 8.43%, rajoni i Mitrovicës me 5.42% dhe rajoni i Gjakovës me 1.20%.


Të dhënat tregojnë se aktiviteti “Prodhimi i mobileve të tjera”, me numër të ndërmarrjeve, dominon në rajonin e Ferizajt, me 40.52%. Rajoni i dytë me radhë është Prishtina me 16.99%, pastaj radhitet rajoni i Prizrenit me 15.69%, rajoni i Gjilanit me 9.80%, i pasuar nga rajoni i Pejës me 8.5%, rajoni i Mitrovicës me 4.58% dhe i Gjakovës me 3.92%.

Aktiviteti “Prodhimi i mobileve në përgjithësi (dhoma dite, dhoma gjumi, dhoma pritje etj.) dhe mobile të zyrave dhe dyqaneve”, për nga numri i ndërmarrjeve është i përqendruar në rajonin e Ferizajt, me 40.28%. në rajonin e Pejës, kemi me 15.28% të ndërmarrjeve në këtë aktivitet, pastaj radhitet, rajoni i Gjilanit me 9.72%, Mitrovicës 9.72%, rajoni i Gjakovës me nga 9.72%, në rajonin e Prishtinës 8.33% dhe atë të Prizrenit 6.94%.

10.2 Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i mobileve

Punësimi të nën sektori i mobileve, është i përqendruar më së tepërmi të aktiviteti “prodhimi i mobileve të tjera” me 43.60%, pastaj kemi një përfshirje të punësuarve të “prodhimi i mobileve të kuzhinës” me 25.15% dhe 18.06% e të punësuarve është të aktiviteti “prodhimi i dyshekëve” .

Figura 42. Punësimi sipas aktiviteteve të nën sektori i mobileve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përveç përqendrimit të punësuarve në aktivitetet e nën sektorit të mobileve, është analizuar edhe shtrirjen e këtyre aktiviteteve në rajonet e Kosovës. Përderisa në aktivitetin “Prodhimi i mobileve të tjera prej druri” ishin të punësuar 43.60%, analizat tregojnë se përqendrimi më i madh i të punësuarve është në rajonin e Ferizajt me 28.74%, pastaj radhitet rajoni i Gjilanit me 18.83%, Pejës 18.04%, Prishtinës me 16.55%, Prizrenit me 13.18%, Mitrovicës 3.27% dhe në rajonin e Gjakovës me 1.39%.

Në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i mobileve të kuzhinës” përfshirja më e madhe e numrit të punësuarve është në rajonin e Ferizajt me 48.63%, atë të Prishtinës me 18.56%, pastaj të Gjilanit me 15.64%, Pejës 7.56%, Prizrenit 6.53% dhe në rajonin e Mitrovicës dhe Gjakovës kemi nën 3.5% të punësuarve në këtë aktivitet.


Përqendrimi më i madh i numrit të punësuarve, në kuadër të aktivitetit “Prodhimi i dyshekëve” është në rajonin e Gjakovës me 53.59%, pastaj në rajonin e Pejës me 37.08%, të Ferizajt me 6.46%, deri sa rajoni i Prizrenit dhe Gjilanit kanë nën 3% të punësuarve në këtë aktivitet. Rajoni i Prishtinës dhe Mitrovicës nuk ka të punësuar në këtë aktivitet.

10.3 Eksporti sipas aktiviteteve të nën sektori i mobileve

Eksporti i nën sektorit të produkteve të mobileve, është një indikator tjetër që është analizuar në këtë raport, pas atij të punësimit dhe numrit të ndërmarrjeve dhe krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, radhitet në vendin e gjashtë.

Të dhënat për krahasimin e eksporteve të aktiviteteve brenda nën sektorit të mobileve, tregojnë se me 50.73% prinë aktiviteti “prodhimi i mobileve tjera prej druri”, pastaj me 24.46% radhitet “prodhimi i mobileve prej kuzhine”, me 16.77%, aktiviteti “prodhimi i mobileve të përgjithshme dhe mobileve të zyrave dhe dyqaneve” dhe prodhimi i dyshekëve, me 8.05%, duke përfshirë mbështetëset e dyshekëve.

Figura 43. Eksportet sipas aktiviteteve të nën sektori i mobileve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përqendrimi më i madh i eksporteve të Kosovës për prodhimet e produkteve në kuadër të aktiviteteve të këtij nën sektori, është në vendet e EFTA-së me 53.55%, duke pas parasysh Zvicrën, pastaj ato të BE-së me 34.62%, në vendet e CEFTA-së me 11.35% dhe në Vendet tjera vetëm me 0.48%.

Produktet e aktivitetit “Prodhimin e mobileve tjera prej druri”, eksportohen në vendet e EFTA-së me 60.89%, në vendet e BE-së me 33.59%. në vendet e CEFTA-së 5.29% dhe në Vendet tjera vetëm me 0.23%. Vendet në të cilat eksportohen më së tepërmi, produktet e këtij aktiviteti janë: në Zvicër 53.62% dhe në Gjermani 26.37%.

Eksporti i produkteve të mobileve të kuzhinës, është i përqendruar në vendet e EFTA-së me pjesëmarrje prej 79.76%, kryesisht në Zvicër me 77.94%, pastaj në vendet e BE-së me 17.55%, (vlera më e lartë në Gjermani 6.71%) dhe vendet e CEFTA-së vetëm me 2.69%.

Produktet e prodhimit të mobileve në përgjithësi (mobile për dhomë të gjumit, dhomë ngrënie, dhomën e ndenjës dhe mobileve të zyrave dhe dyqaneve), eksportohen në vendet e BE-së me 58.63%, kryesisht në Gjermani me 31.07 % dhe në Belgjikë 14.42%, pastaj 29.39% në vendet e EFTA-së, pra në Zvicër me 28.95% dhe në vendet e CEFTA-së me 10.62%, vlera më e madhe në Maqedoni 5.48% dhe me Vendet tjera 1.36%.


10.4 Importi sipas aktiviteteve të nën sektori i mobileve

Pas analizës së ndërmarrjeve, punësimit dhe eksportit, në këtë raport është analizuar edhe importi i nën sektorit të mobileve, krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese - Sektori C.

Ky nën sektorë radhitet në vendin e nëntëmbëdhjetë në importin e sektorit C.

Krahasimi i importit të aktiviteteve të nën sektori i mobileve, tregon se me 47.24%, prinë aktiviteti i “prodhimit të mobileve tjera prej druri”, pastaj radhitet “prodhimi i mobileve në përgjithësi dhe mobileve tjera për zyrë dhe dyqane”, me 45.97 %, “prodhimi i dyshekëve” me 5.05% dhe “prodhimi i mobileve të kuzhinës” me 1.73%.

Figura 44. Importet sipas aktiviteteve të nën sektori i mobileve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI / MTI

Përqendrimi më i madh i importit të këtij nën sektori, është nga Vendet tjera me 50.10%, konkretisht nga Turqia, pastaj nga vendet e CEFTA-së me 24.52%, nga vendet e BE-së me 23.38% dhe, në përqindje të vogël, nga vendet e EFTA-së me 2%.

Kosova importon produktet e aktivitetit “prodhimi i mobileve tjera prej druri”, nga Vendet tjera me 49.89% , nga vendet e CEFTA-së 24.40%, nga vendet e BE-së 23.29% dhe vetëm 2.41% nga vendet e EFTA-së.

Vendet nga të cilat importohen më së tepërmi produktet e aktivitetit “prodhimi i mobileve tjera nga druri”, janë: nga Turqia me 27.23%, nga Kina me 19.52%, nga Serbia me 10.09%, nga Shqipëria 6.93%, nga Maqedonia Veriore me 6.51%, nga Polonia 5.69%, nga Italia 5.51% etj.

Produktet e aktivitetit “Prodhimi i mobileve në përgjithësi (mobile për dhomë gjumit, dhomë ngrënie, dhomë e ndenjës dhe mobileve të zyrave dhe dyqaneve)”, importin e kanë kryesisht nga vendet tjera me 52.02%, pastaj nga vendet e CEFTA-së me 24.84%, nga vendet e BE-së 21.66% dhe nga vendet e EFTA-së me 1.47%.

Vendet prej nga importohen produktet e aktivitetit “prodhimi i mobileve në përgjithësi (mobile për dhomë gjumi, dhomë ngrënie, dhomë e ndenjës dhe mobileve të zyrave dhe dyqaneve)”, janë: Turqia me 27.26%, pasuar nga Kina me 22.64%, Shqipëria 9.58%, me përqindje po thuaj se të njëjtë importon edhe nga Serbia me 9.43%, pastaj nga Italia me 6.95%, nga Maqedonia Veriore me 4.55% etj.

Importi i produkteve të aktivitetit “Prodhimi i dyshekëve”, prinë nga Vendet tjera me 37.63%, pastaj radhiten vendet e BE-së me 33%, vendet e CEFTA-së me 27.84% dhe vendet e EFTA-së me 1.52%.

Produktet e aktivitetit “prodhimi i dyshekëve”, importohen nga këto vende: Kina me 29.83%, pastaj nga Polonia me 20.08%, Maqedonia Veriore 16.97%, Italia 6.93%, Turqia 6.52%, Shqipëria 5.66%, Serbia 5.2% etj.

Përmbledhje

- Nën sektori “Prodhimi i tekstilit” gjatë vitit 2018, krahasuar me vitin 2017, në punësim ka shënuar rënie për 18 të punësuar apo 2.15%, derisa në numër të ndërmarrjeve ka shënuar rritje për 3.25%. Aktiviteti më me ndikim në punësim, gjatë vitit 2018, është “Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit” me 358 të punësuar apo me 43.81%, ndërsa nën aktiviteti “Prodhimi i pëlthurave të pa endura dhe artikujve të pa endur, përveç veshjeve”, është nën aktiviteti me numrin më të ulët të ndërmarrjeve dhe me numër të punësuarve. Eksporti në nën sektorin e prodhimit të tekstilit, kishte shënuar rritje për 16 % në vitin 2017 por në vitin 2018 krahasuar me vitin paraprak ka rënie për 1.11%, përderisa Importi te ky nën sektor, në vitin 2018, ka krahasuar me vitin 2017, ka shënuar rritje për 12.49 %.
- Nën sektori “Prodhimi i veshjeve”, në vitin 2018, ka potencial për punësim pasi që ka shënuar rritje në punësim për 110 të punësuar apo 14.88% si dhe në numrin e ndërmarrjeve për 15.31%, krahasuar me vitin paraprak. Nën aktiviteti me numër më të madhe të punësuarave dhe ndërmarrjeve është “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme”, me 126 ndërmarrje apo me rritje për 0.8%, krahasuar me vitin 2017, dhe me 494 të punësuar ose 11.51% më shumë se në vitin paraprak. Vlen të theksohet se, poashtu rritje në punësim, në vitin 2018, ka shënuar, nën aktiviteti “prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)”, për 75 punëtorë, krahasuar me vitin 2017 edhe pse numri i ndërmarrjeve ka mbetur i njëjtë si në vitin paraprak. Eksporti në nën sektorin e veshjeve, në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 ka shënuar rritje të lartë për 48.7%, ndërsa Importi ka pasur rritje për 18%.
- Nën sektori “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure“, ka ndikim solid në punësim, me lëvizje të lehtë gjatë tri viteve të fundit. Punësimi te ky nën sektor, në vitin 2018, ka shënuar rritje të lehtë për 2 të punësuar apo 0.46%, krahasuar me vitin 2017. Numri i ndërmarrjeve te ky nën sektorë, ka shënuar rritje për 5.4%. Nën aktiviteti, “Prodhimi i këpucëve”, radhitet e para në këtë nën sektor për vitin 2018, me 24 ndërmarrje apo 5.71%, krahasuar me vitin 2017, dhe me 395 të punësuar ose 1.54 % më shumë se në vitin paraprak. Eksporti në nën sektorin e prodhimit të lëkurës dhe produkteve prej lëkurës, në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, ka shënuar rënie për 22.54%. Importi te ky nën sektor, në vitin 2018 ka pasur rritje për 8.94 % krahasuar me vitin paraprak.
- Nën sektori “Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës”, duke u bazuar në punësim dhe eksport, ka potencial për zhvillim. Në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017 në punësim ka pasur rritje për rreth 15%, në eksport rritja ka qenë solide me vetëm 0.96%, deri sa importi ka pasur rritje të lartë për 6.96%.
- Nën sektori i letrës edhe pse krahasuar me nën sektorët tjerë ka numër të vogël të punësimit, me gjithat është premtues në nën aktivitete të caktuara kur e analizojmë

eksportin dhe importin. Eksporti te ky nën sektor në vitin 2018, krahasuar me vitin paraprak ka pasur rënie për 5.28%, deri sa importi ka pasur rritje për 3.64%. Rënie të lartë për 17.87%, te ky nën sektor ka pasur aktiviteti “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit”, deri sa importi ka shënuar rritje për 6.97%. Ky aktivitet edhe për nga vlera e importit e ka vlerën më të lartë se sa aktivitetet tjera dhe artikujt e këtij aktiviteti që dominojnë në import janë (letër tualeti, inde për pastrim ose inde të fytyrës dhe peshqirëve, mbulesa tavoline, tela celuloze ose rrjeta të fibrave celuloze; peshqir dhe tampona sanitare, peceta dhe peceta për bebe dhe artikuj të ngjashëm sanitar dhe artikuj të veshjeve dhe aksesorëve të veshjeve, celulozë).

- Nën sektori “Prodhimit i produkteve kimike” ka potencial për zhvillim kur e kemi parasysh punësimin dhe eksportin. Në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, në punësim ka shënuar rritje për rreth 15%, në eksport, poashtu, një rritje prej 3.45% por rritje ka shënuar edhe në import për 6.13%.

Vlen të theksohet se numri i ndërmarrjeve i nën sektorit “Prodhimi i produkteve kimike” merr pjesë me 2.14%, në totalin e ndërmarrjeve të sektorit te industrisë përpunuese –Sektori C. Sa i përket punësimit, në totalin e të punësuarve, në Sektorin C, nën sektori “Prodhimit i produkteve kimike” merr pjesë me 2.46% të punësuar. Në vitin 2018 eksportet e nën sektorit “Prodhimit i produkteve kimike” marrin pjesë me 2.27% në eksportin e përgjithshëm të Sektorit C ndërsa Importet marrin pjesë me 7.26% në importin e përgjithshëm të Sektorit C.

- Nën sektori “Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës” në punësim e posaçërisht në eksport, ka potencial për zhvillim. Në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, në punësim ka shënuar rritje për rreth 4.6 %, pastaj në eksport ka pasur një rritje të konsiderueshme me 26 % si dhe në import me 6.19%. Vlen të theksohet se numri ndërmarrjeve i nën sektorit “Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës” merre pjesë me një përqindje te konsiderueshme prej 10.4%, në totalin e ndërmarrjeve të sektorit te industrisë përpunuese C. Sa i përket punësimit, në totalin e të punësuarve në sektorin C, nën sektori “Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës” merre pjesë me 9.1 % të punësuarave. Eksportet e nën sektorit “Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës” marrin pjese me një përqindje të konsiderueshme 18 % ne eksportin e përgjithshëm të sektorit C. Importet, në nën sektorin “Prodhimit i produkteve kimike” ne vitin 2018 marrin pjesë me 4.48 % në importin te përgjithshëm te sektorit C.

- Nën sektori “Prodhimi i metaleve” në kuadër të Sektorit C, nga të dhënat e përmbledhura për indikatorët e paraqitur (punësim, numër të ndërmarrjeve, eksport dhe import), paraqet nën sektor premtues në zhvillim ekonomik, gjenerim të punësimit dhe mundësi për të ndikuar në ekuilibrim të bilancit tregtar në vend. Nga të dhënat e vitit 2018, ky nën sektor ka shënuar eksportin më të lartë dhe me 24.45% radhitet në vendin e parë, krahasuar me nën sektorët tjerë në kuadër të Sektorit C. Aktiviteti me eksportin më të lartë, në kuadër të këtij nën sektori është “Prodhimi i

tubave, gypave, profileve bosh dhe pajisjeve të tjera nga çeliku”, me 70.56% eksport dhe 29.44% import. Kur themi se ky nën sektor është premtues në punësim, bazohemi në të dhënat e fundit të analizuara nga viti 2018, krahasuar me 2017 ku ka pas rritje punësimi prej 1.15%, në këtë nën sektor, ose 1051 të punësuar. Aktiviteti me numrin më të madh të koncentruar në punësim është “Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë, si dhe i ferro legurave” me 82.49% të punësuarve në kuadër të këtij nën sektorit. Sa i përket numrit të ndërmarrjeve aktive, në këtë nën sektor kemi vërejtur disa oshilime, nga viti 2018 në atë 2017, ku ndërmarrjet kanë shënuar rënie nga 2.94%, të numrit të ndërmarrjeve. Të dhënat krahasuese nga raportet e eksportit nga viti 2018, tregojnë se në vitin 2017, kanë shënuar një rënie për 24.21%, ndërsa importi ka pas një rritje solide me 28.24%, për periudhën e njëjtë krahasuese. Marr në përgjithësi ky nën sektor, mëton të jetë, krahas disa nën sektorëve tjerë, promotor në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në vend.

- Nën sektori i “Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve” në kuadër të sektorit C, në punësim zë vendin e tretë, në eksport dhe me numër të ndërmarrjeve radhitet e pesta ndërsa në import zë vendin e njëmbëdhjetë. Duke u bazuar në tre indikatorët matës: Punësim, Eksport dhe Import, ky nën sektor ka potencial për zhvillimin e saj të mëtutjeshëm, nëse bëjmë krahasimin vitet 2017-2018, punësimi te ky nën sektor, ka shënuar një rritje për 11% krahasuar me vitin 2017, në eksport në vitin 2018 ka shënuar rritje për 55.84%, në krahasim me vitin 2017, ndërsa importi ka shënuar rritje për 7.90%.
Në kuadër të këtij nën sektori, sa i përket numrit të ndërmarrjeve dhe punësimit dominon aktiviteti “Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre”, ndërsa aktiviteti “Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metalit”, ka eksportin me të madh, përderisa në import prinë “Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre”.
- Nën sektori “Prodhimi i mobileve”, ky nën sektor ka treguar se ka potencial të zhvillimit, krahasuar me nën sektorët tjerë të industrisë përpunuese, radhitet e pesta në punësim dhe e gjashta në eksport. Indikator i punësimit dhe eksportit tregon se nën sektori “Prodhimi i mobileve” në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, ka treguar performancë të lartë, me rritje në punësim për 24.27% apo 452 të punësuar, në eksport ka pasur rritje për 45.22%, deri sa importi ka shënuar rritje për 21.57%. Nën aktiviteti i cili ka pasur rritje më të lartë në (%), në eksport gjatë viti 2018 krahasuar me vitin paraprak është nën aktiviteti “Dyshekë duke përjashtuar, mbështetëset e dyshekëve”, pastaj vjen “Prodhimi i mobileve të tjera”, “Prodhimi i mobileve” dhe ‘Prodhimi i mobileve të kuzhinës’.

Konkludime për rritjen e prodhimit në sektorët e industrisë përpunuese

- Rritja e aktiviteteve prodhuese do të ndikonte në përmirësimin e standardit të jetesës dhe në përmirësimin e bilancit të tregtar. Kosova duhet të investojë në nën sektorët e industrisë përpunuese, konkretisht në prodhim;
- Investimi në teknologji të avancuar, me orientim te NVM-të, mundësojnë rritjen e vlerës së produktit duke zbatuar edhe në standardet e kërkuara, komfor kërkesave të tregut të BE-së;
- Të krijohen lidhjet ndër sektoriale, rrjetëzime, në mes të prodhueseve, furnitorëve dhe transportuesve në bashkëpunim me institucionet relevante për të identifikuar sfidat dhe për të ndërmarr hapat konkret për intervenim dhe zgjidhje të pengesave;
- Institucionet përgjegjëse të Arsimit dhe akterëve tjerë, bashkë me biznesin duhet të bashkëpunojnë në hartimin e programeve arsimore profesionale, që do i përgjigjen nevojave dhe kërkesave të bizneseve për punëtorë të kualifikuar në nën sektorët e Sektorit C;
- Ofrimi i programeve për nxitjen e kompanive për bashkëpunim me institucionet shkencore/hulumtuese, me qëllim zhvillimin e produkteve të reja.
- Zhvillimi i programeve për hulumtimin e tregjeve për eksport si dhe programe të trajnimeve profesionale për plotësimin e nevojave të tregut;
- Krijimi i një fondi të veçantë për subvencione (mjete financiare për bizneset prodhuese të cilat mundë të përdoren për blerje të makinerisë, plotësim të standardeve ndërkombëtare dhe trajnim të stafit);
- Duhet të tejkalohen pengesat që bizneseve, gjatë procesit të prodhimit, që ua shkakton mungesa e energjisë elektrike duke mundësuar plotësimin e kërkesave të tyre me alternativa të tjera.

Referencat

- Agjencia e Statistikave të Kosovës. <http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/>
- Ministria e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Investimeve Strategjike <https://mti.rks-gov.net/desk/inc/media/3E3CB9E3-5FB5-4EF5-BC26-DAD8E11B31A4.pdf>
- Ministria e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Investimeve Strategjike / Rekomandimet e Forumit për Zhvillimin e Politikave Industriale.